

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7695 E mërkur 31 Tetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga VASIL KURETA

Lindja e Mesme, rajon që  
vazhdon të jetojë me krizat



Opinion

Ditës

Nga XHEVAT MUSTAFA

Vrasja e minoritarit grek Kostan-  
din Kacifa nga forcat e RENEAS  
në Bularat të Gjirokastrës, pas  
dyluftimit me policinë shqiptare, më  
28 tetor 2018 ...

"Incident" i rastësishëm  
apo i "investuar"

Lindja e Mesme ka një kohë të  
gjatë që lëngon apo jeton përmes  
luftërave shkatërruese, konflikteve  
e krizave komplekse, që e ka bërë  
vërtet rajon ...  
Vijon në faqet 20-21



"Kujdes me deklarinimin e statusit civil"

## Ambasada e SHBA: Lotaria, si do të bëhet përzgjedhja e emrave fitues

"Tarifat e paguara për aplikimin  
për vizë nuk mund të rimbursohen"

VOLTIZA DURO

Të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë e punojnë në tokën e  
premtuar kanë edhe 7 ditë kohë për aplikimin për Lotarinë  
Amerikane. Ambasada amerikane në Tiranë jep këshillat  
e fundit për aplikantët që do të plotësojnë ...  
Në faqen 9

## QELLOI MBI POLICINE, I ATI : U FRYMEZUA NGA USHTARET E '41-SHIT

# BABAI I VIKTIMES: DJALI IM DONTË TOKAT E EPIRIT

Vrasja e ekstremistit grek, trupi sillet për ekspertizë në Tiranë. Sulmohet  
me bombë molotov biznesi shqiptar në Athinë. Meta: Hetime transparente



(Në foto) Konstandin Kaçifas me flamurin e Vorio - Epirit. Jani Kaçifas, babai i 35-vjeçarit Kaçifas

KRYEMINISTRI NE HAS  
**Rama: Bashën e ka  
zënë paniku për  
zgjedhjet. Gati  
23 padi për shpifje**

Në faqen 6

KRYETARI I PD  
**Basha: Përgjimet  
e Dibrës, emrat  
e deputetëve të  
lidhur me krimin**

Në faqen 4

KRITERET PER TU PLOTESUAR  
**"Luarasi", ja kur  
mbyllen aplikimet  
në "bachelor"  
dhe në "master"**

Në faqen 8

TARIFA E RRUGES  
**Tiranë-Durrës me  
koncesion? Gjikhuri:  
Po e shqyrtojmë  
propozimin 'privat'**

Në faqen 11

"MISIONI DO ECE PERPARA"



**Xhafaj, fushatë për  
mandatin e dytë të  
Veliajt: Për atë  
flet vetë puna e tij**

Në faqen 7

Rrëfimet/ Humbja e Luftës së Dytë Botërore, si e përjetuan humbësit në Tiranë

## Robërit gjermanë: Jeta në Shqipëri pas '44

Kujtimet e ushtarakëve të 'Vermahtit': 39 ditë pa ujë dhe pa parë dritë me sy

NGA FATMIRA NIKOLLI

Deri në vitin 1946, tra-  
jtimi si robër lufte  
ishte relativisht i mirë.  
Lëvizimi në pakufizuar dhe  
po ashtu kishin ushqim  
të mjaftueshëm. Por, situ-  
ata ndryshoi menjëherë, pas  
mbërritjes së misionit të parë



ushtarak sovjetik në Shqipëri,  
në vitin 1946" (9 gusht 1951,  
ish-ushtaraku gjerman Fried-  
rich Husselbach). Historia e  
robërve gjermanë të Luftës së  
Dytë Botërore që shtrihet në  
një hapësirë kohore prej më  
se 17 vitesh, u trajtua nga Dr.  
Marenglen Kasmi ...

Në faqet 18-19

# VRASJA E EKSTREMISTIT HETIMET

Motra e 35-vjeçarit: Të zbardhet ngjarja, duam të dëgjojmë bisedat e policëve në celular

## "Konstandini u frymëzua nga ushtarët grekë, që ranë në Epir në vitet '40-'41"

Jani Kaçifas: Djali ishte patriot, e donte Greqinë

### GJIROKASTËR

Dy ditë pas vrasjes së ushtarit ekstremist grek, Konstandin Kaçifas në fshatin Bularat të Gjirokastrës ka reaguar babai i tij, Jani Kaçifa. Në një prononcim për median greke "Protothema", ai ka thënë se i biri u vra nga policia shqiptare se ishte patriot. Me lot në sy, babai i 35-vjeçarit që u ekzekutua nga forcat RENE A ka deklaruar se djali u frymëzua nga ushtarët grekë të vrarë në vitet '40-'41. "Konstandinos u frymëzua nga ushtarët grekë, që ranë këtu në Epir gjatë viteve '40-'41. Ishte kaq thellë i frymëzuar sa që nuk ndahej nga flamuri grek. Erdhi para pesë vitesh në fshat që të punojë këtu, sepse atëherë kishte punë. Sapo erdhi, ngriti flamurin grek në kodrën ku ranë ushtarët grekë. Ai donte që fshati të kishte një shpirt frymëzues patriotik për helenizmin. Ai denonconte statusin e një bote sovranë, që nuk mbrojt dot Vorio-Epirin. Djali im thoshte se: Ne nuk na duan. Budallentë e botës sovranë dhe të pavarur e lanë Vorio-Epirin jashtë", u shpreh babai i Kaçifas.



Babai i 35-vjeçarit të vrarë, Jani Kaçifa

### REAGIMI I FAMILJARËVE

Në lidhje me vrasjen e Konstandin Kaçifas ka reaguar dhe motra e tij, e cila ka kërkuar që të zbardhet e vërteta. Pavarësisht se vëllai i saj hapi zjarr ndaj policisë duke rrezikuar jetën e tyre, motra e 35-vjeçarit kërkon të mësojë më shumë për bisedat e policëve nga celularët e tyre kur ndodhi ngjarja. "Nga kamerat, nga sateliti, nga çdo mjet që mund të mësojmë atë që duam më shumë në këtë moment familja, në këtë situatë që është, të vërtetën. Jemi në një gjendje shumë të keqe. Duam të dalë e vërteta, të mësojmë fiks çfarë ndodhi, duam të dëgjojmë bisedat e policëve nga celularët e tyre kur ndodhi gjithçka, nga kamerat", ka pohuar shprehur motra e Konstandin Kaçifas. Ndërkaq, mediat e vendit fajnë kanë publikuar dhe një tjetër video të momentit ku mamaja e ekstremistit grek që u vra

## "Do t'i ulim flamujt", politikani grek 'zbardh' sherrin Kaçifas-polic

**GREQI** - Vrasja e minoritarit grek, Konstandinos Kaçifas në Bularat të Gjirokastrës pas një shkëmbimi zjarri me policinë, është sërish çështja e parë në mediat greke. Televizionet helene i kanë kushtuar emisione 'live' çështjes "Kaçifas". Ndërkohë, anëtarë i Lidhjes Panhelenike të Homogjeneve Greke, mjeku Pandelis Patistas, në një intervistë për televizionin "Ant1" ka treguar të tjera detaje nga vrasja e minoritarit 35-vjeçar. Sipas tij, mes Kaçifas dhe policisë shqiptare kishte pasur debate gjatë ditëve të përgatitjes së festës ko-



mbëtare të Greqisë, lidhur me ngritjen e flamurit të shtetit helen. "Gjatë ditëve të përgatitjes për festën kishte filluar debati Kaçifas me

në Bularat, mëson se djali i saj është vrarë. Të emës i kanë thënë se Konstandinos i kërkuar që të dorëzohet, por ai është përgjigjur se nuk dorëzohet se ishte grek dhe prandaj e vranë. Edhe pse kanë kaluar tri ditë nga vrasja e minoritarit grek në Bularat të Gjirokastrës, telefoni i Konstandinos Kaçifas, i cili mbeti i vrarë gjatë një shkëmbimi zjarri me forcat RENE A nuk është gjetur ende. Telefoni i viktimës mund të japë detaje dhe informacione të rëndësishme për të hedhur dritë mbi ngjarjen. Familjarët e Konstandin Kaçifas kundërshtojnë ekspertizën e Institucionit të Mjekësisë Ligjore Shqiptare. Familja minoritare këmbëngul që një ekspert privat të përcaktojë

shkakun e vdekjes së të afërmit të tyre. Mësohet se në Gjirokastrë ka shkuar edhe një mjek ligjor grek, i cili është kërkuar nga familjarët për të marrë pjesë në ekspertizën mjeko-ligjore të trupit të 35-vjeçarit. Nga ana tjetër, avokati grek i familjes Kaçifa paralajmëron se nuk do të zhvillohet ceremoni mortore për 35-vjeçarin e vrarë

### KËRCËNIMI

Një tjetër reagim ka ardhur nga Greqia pas vrasjes së minoritarit grek, Konstandinos Kaçifas. Kësaj radhe është kryetari i grupit parlamentar të Koalicionit Demokratik të Partive të Majta, ish-ministri Andreas Loverdos, i cili "kërcënon" se do e çojnë çështjen deri në Bruksel. Në një reagim të publikuar dje nga mediat greke, Loverdos i bën thirrje kryeministrit Edi Rama të tregojë gjakftohësi. Ai thotë se duhet të ndiqet truga diplomatike dhe përmes Brukselit.



35-vjeçari i vrarë në Bularat, Konstandin Kaçifas

## Sulmohet me molotov zyra turistike shqiptare në Athinë

**GREQI** - Një zyrë turistike shqiptare në Greqi është sulmuar dje me molotov Ngjarja ndodhi në qendër të Athinës. Dy persona të maskuar kanë hedhur molotov, duke shkakuar dëme materiale në hyrje dhe në brendësi të zyrës. Policia po heton mbi ngjarjen që ndodhi rreth orës 01:00 në lagjen "Dhili-jani". Sipas autoriteteve, mendohet se shpërthimet me molotov kanë qenë të organizuara. Po hetrohet nëse ngjarja ka lidhje me episodin e Bularatit, ku minoritari grek u qëllua për vdekje gjatë një dyluftimi me forcat RENE A.



në Bularat pa pasur dosjen e plotë të autopsisë. Në një intervistë për televizionin "Antena" në Greqi, Kostas Jovanopoulos tha se familja nuk ka informacione të sigurt për vrasjen e djalit nga policia shqiptare. "Nuk kemi njoftim zyrtar si familje për ngjarjen e rëndë. As nuk është hapur dhe as nuk është mbyllur dosja. Informacionet nuk janë të sigurt. Ka përfunduar faza e parë e procedurës nga autoritetet shqiptare, por nuk kemi asnjë informacion zyrtar ata për autopsinë. Nuk dimë as kush e ka bërë dhe as kur është bërë autopsia".

### NGJARJA

Në prag të zhvillimit të festës së Greqisë, e cila si çdo vit u organizua edhe në qendër të fshatit Bularat në Gjirokastrë, të shtëna me armë tronditën zonën. Policia, e cila ishte stacionuar në qendër të fshatit për mbarëvajtjen e festës menjëherë është nisur në drejtimin nga janë dëgjuar të shtënat, ndërsa identifikoi edhe personin që qëlloi me

armë. Konstandin Kaçifa sapo ka parë shërbimet e policisë që po afroreshin në drejtim të tij ka hapur zjarr me breshëri ndaj punonjësve të policisë, duke rrezikuar jetën e tyre. Fatmirësisht nga të shtënat nuk ka punonjës policie të plagosur; por vetëm është thyer xhami i mjetit të policisë. Policia menjëherë ka rrethuar zonën, ku përsëri ky shtetas ka hapur zjarr në drejtim të punonjësve të policisë që po e ndiqnin. Shtetasi Konstandinos Kaçifa u fut në thellësi të fshatit ku forcat "Shqiponja" dhe shërbimet e tjera të Drejtorisë Vendore të Policisë vijuan krehjen e zonës për të bërë të mundur kapjen e tij. Në ndihmë të shërbimeve të Policisë së Gjirokastrës shkoi dhe një helikopter i Ministrisë së Brendshme dhe forcat speciale RENE A nga Tirana, të cilat bënë të mundur edhe lokalizimin e autorit. Por, pasi nuk iu përgjigji thirrjes së policisë për t'u dorëzuar, 35-vjeçari qëllonte me armë zjarri, ndërkohë që mbeti i vrarë.



Kërkesa e Krimeve të Rënda, trupi i 35-vjeçarit sillet për autopsi në Tiranë

# Vrasja e ekstremistit Konstandin Kaçifas, Prokuroria greke nis hetimet

*Urdhëroi transferimin e dosjes nga Janina në Athinë, si krim kundër një shtetasi grek i "shkallës së lartë"*

**GJIROKASTËR**

**T**rupi i ekstremistit grek që u vra të dielën në Bularat të Gjirokastrës është transportuar dje në Tiranë, ku pritet t'i nënshtrohet një tjetër ekspertizë mjeko-ligjore. Pavarësisht pretendimeve të familjarëve për një ekspertizë greke, trupi i Konstandin Kaçifas është nisur nga morgu i Gjirokastrës drejt kryeqytetit, me kërkesë të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Burime nga organi i akuzës dje bënë me dije se trupi i 35-vjeçarit që u ekzekutua nga forcat RENEA, pasi hapi zjarr ndaj këtyre të fundit nuk do të varroset deri në përfundim të procedurave dhe autopsisë së plotë të trupit, me qëllim që të mos ketë kundërshtime dhe pretendime nga familja. Kërkesa e Krimeve të Rënda erdhi tri ditë pas vrasjes së Kaçifas, familjarët e të cilit refuzuan deri në orën 16:00 të ditës së djeshme që ta tërheqin trupin, pasi kërkonin ekspertizë greke. Familjarët ishin përgatitur që ta bënin ekspertizën privatisht në Dervican me mjek grek. Të afërm të Kaçifas kërkojnë që të saktësohet se nga çfarë distance është qëlluar 35-vjeçari dhe nëse plumbat që kanë goditur makinën e policisë janë nga arma e tij. Ndërkaq, edhe pse Prokuroria shqiptare refuzoi hetuesit grekë që të bëhen pjesë e hetimeve për vrasjen e ekstremistit 35-vjeçar, drejtësia greke ndërhyr zyrarisht në hetimin e çështjes. Mësohet se motra e Kaçifas dorëzoi dje në Prokurorinë greke kartën e identitetit grek të viktimës si shtetasi grek. Ndërsa prokuroria e vendit fqinj ka urdhëruar transferimin e dosjes hetimore nga Janina në Athinë, si krim i kryer kundër një shtetasi grek e madje i "shkallës së lartë".

**BANORËT E BULARATIT**  
Banorët e Bularatit janë ende të tronditur nga ngjarja e ndodhur të dielën në fshatin e tyre, ku mbeti i vranë Konstandin Kaçifas. Ata nuk i besojnë versionit të policisë shqiptare se ishte i riu që hapi zjarr mbi forcat e rendit, por kanë pothuajse të gjithë të njëjtin mendim se 35-vjeçari u provokua qëllimisht. Ish-kryeplaku i fshatit i bën thirrje kryeministrit Edi Rama të mos e etiketojë 35-vjeçarin si ekstremist. Në shtëpinë e të riut nuk janë vetëm bashkëfshatarët që shkojnë për të ngushëlluar. Ka edhe miq të tij të ardhur nga Greca.



**Avokati i Popullit në Bularat: Do kryejmë hetim të pavarur administrativ**

**GJIROKASTËR** - Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, Petrit Azemi ka mbërritur në fshatin Bularat, ku ka vizituar familjarët e 35-vjeçarit të vranë, Konstandin Kaçifas. Para mediave, Azemi tregoi që kishte takuar familjarët e të ndjerit duke sqaruar se institucioni që ai përfaqëson do të kryejë një hetim të pavarur administrativ. I pyetur nga gazetarët grekë nëse Kaçifas mund të kapej dhe të mos vritej, ai u përgjigj se hetimet do ta zbardhin një pretendim të tillë. Ndërsa, përsa i përket ekspertizës nga pala greke, ai u shpreh: "Jemi në dijeni të faktit se me kërkesë të familjarëve kemi kërkuar një ekspertizë mjeko-ligjore. Autopsia e tij është kryer, tani është e drejta e tyre që të marrin të gjitha aktet që shohin të arsyeshme". Burime nga vendngjarja bëjnë me dije se pala greke pretendon se ushtari ekstremist grek është plagosur dhe më pas është ekzekutuar. Ata pretendojnë se në vendngjarje ka shenja gjaku në hapësirë të gjërë dhe jo vetëm në një vend.



**URDHRI**  
Edhe pse Prokuroria shqiptare refuzoi hetuesit grekë që të bëhen pjesë e hetimeve për vrasjen e ekstremistit 35-vjeçar, drejtësia greke ndërhyr zyrarisht në hetimin e çështjes. Mësohet se motra e Kaçifas dorëzoi dje në Prokurorinë greke kartën e identitetit grek të viktimës si shtetasi grek. Ndërsa prokuroria e vendit fqinj ka urdhëruar transferimin e dosjes hetimore nga Janina në Athinë, si krim i kryer kundër një shtetasi grek e madje i "shkallës së lartë".

**"Më shumë gjëra na lidhin se na ndajnë mes dy vendeve tona"**

## Ekzekutimi i minoritarit, ambasadorja shqiptare në Greqi: Të mos e politizojmë ngjarjen

**GREQI** - Ambasadorja shqiptare në Greqi, Ardiana Hobdari ka kërkuar të mos politizohet çështja e vrasjes nga RENEA të minoritarit grek Konstandin Kaçifas në Bularat të Gjirokastrës. Në një prononcim për mediat greke, ambasadorja shqiptare në vendin fqinj ka thënë se më shumë gjëra na lidhin sesa na ndajnë mes Shqipërisë



dhe Greqisë. "Nuk duhet të politizojmë ngjarjen, pasi më shumë gjëra na lidhin

sesa na ndajnë mes dy vendeve tona. Jam informuar nga pala greke dhe jemi në kontakt edhe me palën shqiptare për çështjen", - ka deklaruar Ardiana Hobdari. Ndërkohë mbrëmë, minoritarët grekë të Shqipërisë kanë zhvilluar një protestë paqësore sheshin "Sintagma" të Athinës për nderuar kujtimin e minoritarit Kaçifas.

mund të vijmë vetëm në rolin e vëzhguesit, por jo aktivë në hetime. Po të njëjtat burime sqaruan se ndërhyrja në hetime nga një vend fqinj është e ndaluar me ligj. **HETIMET**  
Pas ngjarjes së ndodhur në fshatin Bularat të Gjirokastrës, pala greke ka shfaqur interes që të marrë pjesë në hetimet që do zhvillojnë autoritetet shqiptare, për vrasjen e Konstandin Kaçifas. Por, praninë e tyre përkrah prokurorëve shqiptarë nuk e lejon legjislacioni shqiptar, por edhe Kodi Penal shqiptar. Burime nga Prokuroria e Krimeve të Rënda pohuan se ekspertët grekë nuk mund të kryejnë hetime, kjo pasi një gjë e tillë është e ndaluar. "Hetimet do të kryhen nga pala shqiptare. Grekët mund të dërgojnë ekspertët e tyre, të cilëve do u lejohet të jenë vetëm në rolin e vëzhguesve, por jo që të kryejnë hetime", thanë burimet nga organi i akuzës. Po këto burime pohuan se ngjarja ka motiv nacional-

**Njoftim për shitje me ankand**

**Power & Justice (P&J)** sh.p.k. na baze le nentë 567,568 të K.P. Civile do të zhvillojë ankandin e parë për pasurinë e debitorit S. Shera, dhe O. Shera. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga: "Dyqan" me numër pasurie 6/279, Vol. 37, Fq.64, në Z.K.Nr. 8350, me sipërfaqe 35 m<sup>2</sup>, e në Zvrrp Tiranë, Ankand, fillon me çmimin fillestar në masën 36.400 Euro "Dyqan" me numër pasurie 6/279, me Z. Nr. 8350, me sipërfaqe 4,8 m<sup>2</sup>, në Zvrrp Tiranë Ankand, i pasurisë "Dyqan" fillon me çmimin fillestar në masën 3.840 Euro Ankandit do të zhvillohet në datë 12.11.2018 prej orës 15:00 në sallin e shoqërisë Buvë "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5. Ofruesit mund të paraqiten ose të kontaktojnë tel. 09355 67 20 82 543 ose e-mailit llir\_derivshaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com.

# NGJARJA NE BULARAT REAGIMET

Dosje si 339, kreu i PD: Ka përgjime si të Dakos, kush duhet të arrestohet

## Vrasja e Kaçifas, Basha: Ngjarje kriminale, nacionalizmi i shtirur

### "Rama, njeri i destabilizuar mendërisht"

Valentina Madani

Kreu i PD-së Lulzim Basha e cilësoi ngjarje kriminale atë çfarë ndodhi të dielën në Bularat të Gjirokastrës ku policia shqiptare vrau 35-vjeçarin minoritar. Gjatë një bashkëbisedimi dje me gazetaret z.Basha dënoi përpjekjet sipas tij të kryeministrit Rama për ta politizuar atë. Kreu i PD-së akuzoi kryeministrin Rama se ka përqendrim që të zhvendosë vëmendjen me deklarata nga qeverisja e tij. "Rama kërkon që të zhvendosë në mënyrë artificiale vëmendjen, duke pompuar një ngjarje kriminale që duhet trajtuar si kriminale. Është tregues i gjendjes ku ndodhet ai dhe qeverisja e tij. Ai kërkon të largojë vëmendjen nga fakti që nuk kemi qeveri, por një bandë kriminale që na drejton", deklaroi Basha. Kreu demokrat shtoi më tej: "Ai jo vetëm përdor ngjarje të tilla kriminale, por edhe prodhon ngjarje që çojnë në destabilizim të vendit dhe rajonit". Basha e quajti të papranueshme retorikën që kryeministri Rama pati me Berishën lidhur me këtë ngjarje. "Kjo është një ngjarje kriminale dhe përpjekjet për ta kthyer atë, në ngjarje politike i shërbejnë vetëm atyre që duan ta largojnë mendjen nga kriza e thellë politike ku ndodhet vendi në këtë anë të kufirit dhe pa dyshim ka faktorë në anën tjetër të kufirit që duan ta shfrytëzojnë për axhendën e tyre politike. Të dyja përpjekjet janë të dënueshme. Në rastin e përpjekjes së Edi Ramës për të zhvendosur në mënyrë artificiale dhe për të pompuar me retorikë të papranueshme kundër eksponentëve të opozitës, ish-kryeministrit Berisha e të tjerëve, një ngjarje e cila është kriminale dhe duhet trajtuar e tillë, është vetëm tregues i gjendjes ku ndodhet ai dhe qeverisja e tij. Ka pushuar së qeverisuri dhe do të kapet pas gjithçkaje për të larguar vëmendjen nga fakti që sot nuk kemi qeveri, por një organizatë kriminale, e cila rolin krye-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

**DENONCIMI**  
Ish-kryeministri Berisha postoi dje një denoncim sipas të cilit banda Avdyllajve të Shijakut ka rrahur Vangjush Dakon në zyrën e tij. "Ka qenë Edi Rama ai që i ka pajtuar, pasi janë ulur në një restorant në Durrës për rreth tri orë", shprehet z.Berisha.



Forcat RENEA në Bularat

### "ZGJEDHJET, MË SHPEJT NGA Ç'MENDOHET"

Kreu i PD-së mbledhi grupin parlamentar ku u diskutua për situatën politike dhe procesin e zgjedhjeve brenda strukturave. Basha i ka vënë deputetët para faktit se përballja me qeverinë nuk do të jetë e largët duke u kërkuar që të intensifikojnë takimet me qytetarët. "Ne do të përgatitemi intensivisht për zgjedhje dhe do i fitojmë ato. Duhet të bëhemi qatë, dita e përballjes me qeverinë mund të jetë më e shpejtë sesa mendjëm. Skandale të tjera do të dalin. Minimumi 15 mandate nga PS janë të palegjittuara.", - tha Basha.

### "35-vjeçari, i indoktrinuar nga ekstremistët"

## Bularati, Tritan Shehu: Policia reagoi drejt. Rama më shokoi



Mendoj se kjo ngjarje nuk ka pse të impresionojë marrëdhëniet Shqipëri-Greqi", - u shpreh Shehu. Ndërkohë, hapjen e një banderole dhe nga ultrasit e Partizanit në stadium, deputeti e sheh si

shqetësues dhe të nxitur nga dikush. "Mbrëmë (të hënën) në stadium pashë një parullë që më shqetësoi shumë që nuk kishte lidhje me futbollin dhe që nxit urrejtje. Janë elementë të nxitur nga dikush. Nacionalizmi është ndalesa e fundit për atë që ka shkuar drejt greminës", tha z.Shehu. Ai komentoi deklaratat e ish-kryeministrit Sali Berisha për ngjarjen e Bularatit dhe reagimin e kryeministrit Edi Rama, për të cilin tha se e ka shokuar. "Ky incident bëri të shpërtheshë disa simptoma. U shokova mbrëmë. Zoti

Berisha bëri një arsyetim racional e të qetë dhe më pëlqeu. Pas pak minutash kryeministri i Shqipërisë më shokoi, doli me një prononcim të papranueshëm, nuk ishte fjala vetëm për fyerjet por kërkonte t'i vishte një xhakë të ultranacionaliste. Kërkonte të shfrytëzonte politikisht të papranueshëm, nuk ishte fjala vetëm për futuri që këshu futuri më të rrezikshme për vendin. Mesazhi i Ramës i papërshtatshëm, jashtë kontekstit që nuk i shërben situatës", - tha Shehu.

bergut, në vetvete është pjesë e disa hetimeve të nisura nga prokuroria, disa prej tyre të nisura me kërkesën tonë, siç është dosja e Dibres ku janë interceptuar në mënyrë ligjore, pra janë krijuar fakte dhe prova ligjore të përfshirjes së Saimir Tahirit, në atë kohë ministër i Brendshëm, Damian Gjiknurit, ende ministër dhe të pakten të 4 deputetëve të PS në transaksione të së njëjtës natyre si dosja 339 me banda të krimit të organizuar, me figura të krimit të organizuar si Ymer Lala dhe të tjerë eksponentë të krimit të organizuar për të ushtruar presion, për të blerë vota dhe për të kërcënuar votuesit e Dibres në masakrën e shtatorit 2016 që ishte prologu dhe prova gjenerale për skemën që u aplikua në gjithë vendin në zgjedhjet e qershorit 2017. Në kuadër të këtyre të fundit, pra të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, siç është dëshmuar jo vetëm nga Emiliano Nuhu, por dhe burime të tjera, Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe prokuroria e Elbasanit kanë prova faktike të përfshirjes në transaksione kriminale të dy eksponentëve të PS-së, kryedeputetit për PS-në Taulant Ballës dhe Qazim Sejditit", - deklaroi Basha.

referuar kryesisht dosjes 339, për shkak të cilës u arrestuan dy ish-deputetë socialistë dhe në përgjime doli emri i kryebashkiakut Vangjush Dako. Z.Basha përmendi emra të tjerë të Partisë Socialiste të përfshirë në trans-

skasione dhe të përgjuar ashtu si Vangjush Dako në dosjen 339. Ai përmendi emrat e Saimir Tahirit, Damian Gjiknurit, Taulant Ballës, Qazim Sejditit dhe deputetë të tjerë të PS duke i akuzuar se kanë bash-

këpunuar me figura të krimit të organizuar për të blerë vota dhe për të kërcënuar votuesit në Dibër dhe Elbasan. "Në rrafshin e skandaleve kriminale mund t'ju them se dosja 339, nga e cila keni parë vetëm majën e ajs-

**Njoftim për shitje me ankand të tretë**  
Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e tretë për pasurinë e dorëzuesin K Sula te ndodhur ne Mallakaster. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:  
\* "Pasuria A" me nr. 206/48, me sipërfaqe 2500 m2 në ZK 2869 vol. 5 lq31, dhe "Ara" me nr.206/7 me vol.4, faqe 244, në ZK 2869 vol me sipërfaqe 500 m2.  
Ankandi tretë i sipërfaqes totale 3.000 m2 fillon me cimin fillestar 806.400 lekë  
\* "Pasuria" Ndertese " pjesë e vecuar me nr. 70/15, vol.6, faqe 85 me sipërfaqe 51 m2 e ndodhur në ZK 2869 Ankandi tretë fillon me cimin fillestar 252.419 lekë  
Ankandi është progresiv dhe do të zhvillohet ditë 23.11.2018 në orën 15:00 në Bulv "G.Fishta" Kulla 1,Kati 2, zyra.5. Kont. tel. 0672082543, e-mailit tllr\_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com.

**Njoftim për shitje me ankand**  
Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar ne nenin 567.568 e vijues te K.P.LC do të zhvillojë ankandin e pare për pasurinë e pales debitore B Kambaraj dhe L Kambaraj. Pasuria që shitet në ankand përbëhet nga:  
\* "Trulli e Godine te kateshe" : me numer pasurie 14/283 ne ZK Nr.8602, volumi 35, faqe 144, trulli 300 m2, sipërfaqe e kati perthe 117.9 m2 ne Lagjen 10 Korrikune Vlore  
Ankandi i pasurisë fillon me cimin fillestar në masën prej 8.960.000 Lekë  
Ankandi qendron i hapur 15 dite dhe do të zhvillohet në datë 08.11.2018 në orën 15:00 në Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 2.Tirane Ofertuesit duhet të tërheqin dokumentacionin të kontaktujnë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-mailit tllr\_dervishaj@yahoo.com si dhe WEB www.powerjustice-al.com.



Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta e konsideron një ngjarje të izoluar, atë që ndodhi në fshatin Bularat më 27 tetor, ku mbeti i vrarë nga forcat RENEA 35-vjeçari Kostandin Kaçifas. Presidenti Ilir Meta reagoi dhe përmes zëdhënësit të Presidencës, Tedi Blushi, për ngjarjen në Bularat. Kreu i Shtetit u bën apel partive politike të qëndrojnë larg përpjekjeve për të shfrytëzuar këtë ngjarje për retorikë nacionaliste e nevoja politike destruktive. Sipas presidentit, kjo ngjarje e izoluar nuk mund të zbehtë miqësinë shqiptaro-greke. Gjithashtu, presidenti dënon banderolën në shkallët e Selman Stërmasi" gjatë ndeshjes Partizani-Skënderbeu. "Presidenti i Republikës, Ilir Meta, vlerëson rëndësinë e hetimeve transparente e shteruese dhe shpreh bindjen e thellë se kjo është një ngjarje e izoluar, e cila nuk mund të zbehtë miqësinë shqiptaro-greke. Minoriteti grek në Shqipëri dhe emigrantët shqiptarë në Greqi do vazhdojnë të jenë ura solide të këtyre marrëdhënieve dhe kësaj miqësie. Presidenti Meta vlerëson qëndrimet e ministres së Kulturës së Greqisë lidhur me ngjarjen dhe iu bën apel të gjithëve të qëndrojnë larg përpjekjeve për të shfrytëzuar këtë ngjarje për retorikë nacionaliste e nevoja politike destruktive", thuhet në reagimin e kreut të shtetit. Në të njëjtën kohë Presidenti Meta thekson se parulla e shfaqur të hënën në shkallët e stadiumit "Selman Stërmasi" gjatë ndeshjes Partizani-Skënderbeu është jo vetëm e papranueshme, por thellësisht e dënueshme. "Një parullë e tillë antisportive dhe raciste është edhe një fyerje për korifenjtë e futbollit shqiptar, që nderuan fanellën e ekipit tonë kombëtar duke pasur kombësinë greke. Sidoqoftë, këto ngjarje të izoluar duhet të na shërbejnë si një kamberë alarmi për të parandaluar dhe frenuar që në gjenezë pasojat e gjuhës së urrejtjes mes popujve tanë", deklaroi Presidenti i vendit, Ilir Meta.

TAKIMI



Terrorizimi, Meta takon Presidentin e Pakistanit

Presidenti Ilir Meta takoi dhe Presidentin e Pakistanit Arif-Ur-Rehman Alvi gjatë vizitës së tij në Stamboll. Në bashkëbisedimin me homologun e Pakistanit, Meta bisedoi për intensifikimin e marrëdhënieve dy dhe shumëpalëshe dhe ato të ekonomike. Meta e siguroi atë për vazhdimin e forcimit të bashkëpunimit tradicional midis dy vendeve tona, veçanërisht atyre në fushën ekonomike dhe shkëmbimeve tregtare. Presidenti Meta inkurajoi Presidentin Alvi në angazhimin e tij kundër ekstremizmit dhe terrorizmit, për t'i dhënë Pakistanit një rol të rëndësishëm për paqen në rajon. Të dy Presidentët u dakortësuan për të shkëmbyer vizita në nivelin më të lartë. Z. Meta ndodhet në Turqi që prej ditës së djeshme kur mori pjesë në inaugurimin e aeroportit të ri në Stamboll.

Presidenti në qendërën "Marshall": NATO s'lejoi që Ballkani të bëhej Lindja e Mesme e Evropës

# Vrasja në Bularat, Meta: Ngjarje e izoluar, jo retorikë nacionaliste

"Të mos përdoret për qëllime politike"



Presidenti Ilir Meta

REAGIMI

"Presidenti Ilir Meta vlerëson rëndësinë e hetimeve transparente e shteruese dhe shpreh bindjen e thellë se kjo është një ngjarje e izoluar, e cila nuk mund të zbehtë miqësinë shqiptaro-greke. Minoriteti grek në Shqipëri dhe emigrantët shqiptarë në Greqi do vazhdojnë të jenë ura solide të këtyre marrëdhënieve dhe kësaj miqësie", thuhet në reagimin e Presidencës.

"Me Greqinë zgjidhni çështjet e vjetra"

## Vrasja në Bularat, Soreca: Shqipëria të respektojë minoritetet

Bashkimi Evropian përmes ambasadorit Luigi Soreca kërkon mbrojtjen e minoriteteve, ndërkohë që nga Shqipëria dhe Greqia kërkon zgjidhjen për mes një marrëveshje dypalëshe të çështjeve të vjetra. Këtë qëndrim shprehu dhe në Fier kreun e delegacionit të BE-së, Luigi Soreca për ngjarjen e ndodhur në Bularat të Gjirokastrës, ku mbeti i vrarë një minoritar grek nga forcat RENEA. Kreu i diplomacisë europiane, i pyetur sesi do të ndikojë mes Shqipërisë dhe Greqisë kjo çështje, tha se ajo është një çështje dypalëshe dhe sipas tij, është e rëndësishme që dy vendet të gjejnë një marrëveshje për rrugëtimin e Shqipërisë dhe Greqisë drejt BE. "Marrëdhënia mes Shqipërisë dhe Greqisë është një çështje dypalëshe. Është e rëndësishme për ne si BE që Greqia dhe Shqipëria të gjejnë një marrëveshje për rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE-së. Është e rëndësishme që komunitetet në Shqipëri, pakicat në çdo pjesë të vendit të mbrohen", tha z.Soreca.



DEKLARATA

"Marrëdhënia mes Shqipërisë dhe Greqisë është një çështje dypalëshe. Është e rëndësishme për ne si BE që Greqia dhe Shqipëria të gjejnë një marrëveshje për rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE. Është e rëndësishme që komunitetet në Shqipëri, pakicat në çdo pjesë të vendit të mbrohen", tha z.Soreca.

Brendshme ka ndërmarrë disa operacione shumë të rëndësishme dhe në krye të tyre ka qenë ministri Xhafaj, ndaj vlerësimi ynë për ministrin është i qartë. Ne shpresojmë që ministri i ardhshëm dhe gjithë qeveria do të vazhdojë luftën kundër kimit të organizuar në të gjithë vendin", theksoi ambasadori i delegacionit të BE-së në Tiranë. "Marrëdhënia mes Shqipërisë dhe Greqisë është një çështje dypalëshe. Është e rëndësishme për ne si BE që Greqia dhe Shqipëria të gjejnë një marrëveshje për rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE-së. Është e rëndësishme që komunitetet në Shqipëri, pakicat në çdo pjesë të vendit të mbrohen", tha z.Soreca.

Brendshme ka ndërmarrë disa operacione shumë të rëndësishme dhe në krye të tyre ka qenë ministri Xhafaj, ndaj vlerësimi ynë për ministrin është i qartë. Ne shpresojmë që ministri i ardhshëm dhe gjithë qeveria do të vazhdojë luftën kundër kimit të organizuar në të gjithë vendin", theksoi ambasadori i delegacionit të BE-së në Tiranë. "Marrëdhënia mes Shqipërisë dhe Greqisë është një çështje dypalëshe. Është e rëndësishme për ne si BE që Greqia dhe Shqipëria të gjejnë një marrëveshje për rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE. Është e rëndësishme që komunitetet në Shqipëri, pakicat në çdo pjesë të vendit të mbrohen", tha z.Soreca.

acionit të BE-së në Tiranë. Deklaratat e ambasadorit të BE u bënë pas një aktiviteti në Fier. Por, ambasadori i Bashkimit Evropian në Tiranë, Luigi Soreca, është optimist se javën e ardhshme komisioni parlamentar do të përfundojë punën për reformën zgjedhore dhe ta votojë në Kuvend. Kjo do të thotë se opozita sipas Sorecës, duhet të kthehet në Kuvend dhe të përfundojë këtë proces. "Ne jemi shumë të kënaqur nga puna e bërë nga komisioni i reformës zgjedhore, me asistencë nga ekspertët ndërkombëtarë me një dialog ndërpartiak shumë pozitiv. Kjo duhet të finalizohet në parlament, me punën e përbashkët të të dy kraheve. Në jemi shpresëplotë se gjatë javës tjetër, komisioni i reformës zgjedhore do të rinisë punën dhe të votojë këtë reformë", u shpreh z.Soreca.

kanë provuar të jenë të dobishëm në të dy kohët e luftës dhe paqes. Dua të theksoj faktin se ndërhyrja e NATO-s, veçanërisht nga SHBA dhe më pas përfshirja e BE në një mënyrë vendimtare të të vendosur, shpëtoi Ballkanit të bëhet Lindja e Mesme e Evropës", u shpreh ai. Pjesëmarrësit ndjekin Programin e Qendres "Marshall" për Studimet e Aplikuara të Sigurisë, i cili siguron një ar-

sim të nivelit të lartë në politikë e sigurisë, çështjet e mbrojtjes dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me një gamë të gjerë të profesionistëve të sektorit të sigurisë nga qeveritë dhe organizatat joqeveritare anëmbanë botës. "Fjalimi i presidentit ishte i përkryer në kohën kur pjesëmarrësit po përfundonin pjesën akademike të programit", tha drejtori i programit PASS, koloneli Carsten Treder. "Ne kemi

denti u përgjigj pyetjeve nga pjesëmarrësit lidhur me temat që lidhen me sigurinë në Ballkan. "Ai ishte i angazhuar dhe i singertë", tha Dejtani. "Sipas mendimit tim të përlur, ai bëri shumë për imazhin e Shqipërisë sot para klasës sonë PASS, duke u folur njerëzve jo vetëm nga Ballkani, por edhe nga pjesa tjetër e Evropës, Afrikës, Azisë, Lindjes së Mesme dhe Veriut dhe Amerika e Jugut", deklaroi ai.

# QEVERISJA TAKIMET

Kryeministri: Kthejini pikat e basteve në zyra për popullin, që të lani edhe mëkatet

## Rama, Bashës: Mbahu fort, të ka zënë paniku nga zgjedhjet lokale

"Artist, gati 23 padi ndaj teje për shpifje"

Kryeministri Edi Rama ironizoi sërish djemë Partinë Demokratike. Në një status në Twitter, kreu i qeverisë shkruan se Departamenti Antishpifje ka kryer 23 padi ndaj teje. Rama i kujtoi Bashës se akuzat ndaj tij i bën pasi e ka zënë paniku nga zgjedhjet e ardhshme vendore. Pas deklaratave të liderit të opozitës, Lulzim Basha, Rama me ironi shkruan "konferencë shtypi me diarre intensive". Ndërkohë, Rama nga krahu tjetër i përgjigjet "të kanë zënë të prerat nga zgjedhjet që po vijnë e po bën gati terrenin e humbjes fitimtare të radhës". "Artist, jam i impresionuar! Departamenti Antishpifje paska konstatuar sot shkaqe për 23 padi ndaj teje. Konferencë shtypi me diarre intensive më thonë? E di kxhan e di, të kanë zënë të prerat nga zgjedhjet që po vijnë e po bën gati terrenin e humbjes fitimtare të radhës. Mbahu fort", shprehet z.Basha.



Kryeministri Edi Rama dje në Kukës

### SALI BERISHA

Kryeministri Edi Rama zhvilloi dje disa takime dhe aktivitete në Has, por ish-kryeministri Sali Berisha publikoi një mesazh ku thuhet se nxënësit e gjimnazit në Krumë po mbahen të mbyllur jashtë dëshirës së tyre për të pritë kryeministrin Rama.

### Ndryshon balanca në KQZ, PS merr shumicën

## Fino: Pse e regjistruat PD në zgjedhje? Skënderi: Pse nuk e ankimove?

Kandidatët e PS-së për KQZ Bledar Skënderi dhe Rezarta Bitri kaluan dje seancën dëgjimore dhe u votuan në komisionin e ligjeve ndërkohë që opozita ka refuzuar të paraqesë emrat e saj. Por mbledhja e djeshme e ligjeve nuk kaloi pa replika mes anëtarëve socialistë të komisionit dhe kandidatit të propozuar nga vetë PS, Bledar Skënderi. Ish-të Bashkim Fino që pyeti Skënderin, se deri para pak kohësh ka qenë pjesë e KQZ-së, se përse u vendos regjistrimi i opozitës në zgjedhjet e 2017-ës, kur afati ligjor kishte kaluar. "Si ka mundësi që regjistruat subjektin politik PD jashtë afatit për zgjedhjet e vitit 2017. Domethënë bëtë një shkelje ligjore ndërkohë që kërkoni një mandat" - deklaroi Fino.



Në përgjigjen për socialistin Fino, Skënderi u shpreh se në bazë të Kodit Zgjedhor, çdo kandidat për deputet ka pasur të drejtën e ankimit të KQZ. "Kundër vendimit tonë nuk është bërë asnjë ankim as nga subjektet zgjedhore, as nga kandidatët për deputetë, kështu që unë menjëherë procedura ka qenë e saktë. E dyta dhe më e rëndësishmja, në kemi si mision garantimin e

zgjedhjeve të lira dhe të ndershme të Shqipërisë dhe ky qëllim prevalon mbi rregull apo normë të shkruar". tha Skënderi. Të njëjtin interes pati edhe socialisti tjetër Alket Hyseni, i cili kërkoi të dinte edhe përse KQZ nuk ka hetuar mbi financimin e partive në fushatë, edhe pse kishte një rezolutë nga Kuvendi. Para komisionerëve të Ligjeve, kandidatja Rezarta Bitri pranoi se depolitizimi i administratës zgjedhore është pozitiv, porse kërkon kohë. Pas votimit në seancë plenare, KQZ do të kenë numrin e nevojshëm, prej 5 anëtarësh, për të vijuar punën dhe përgatitjen e zgjedhjeve të ardhshme, edhe nëse opozita nuk plotëson vendet që i takojnë asaj me ligj.

mirë të ndihmojnë qytetarët. Kështu edhe lajmë mekatet që kanë bërë me skedinat" - tha Rama nga Hasi. Ai pohoi se platforma "shqipëriaqëduam.al" është një mekanizëm efikas, që po fuqizohet dita-ditës, falë qytetarëve, të cilët adresojnë në të ankesat e tyre. Më vjen mirë të them se platforma më tërësinë e saj, ka zgjidhur rreth 16 mijë probleme. Probleme në thonjeza të vogla, të barta, prej muajsh dhe vitesh. Probleme me pensionet, prob-

leme me mbi faturimin, diplomat, probleme nga ata që hera-herës kthehen në pamundësi për njerëzit, ku në një zyrë duhet të marrin atë që u takon ngecin. Platforma është transformimi i shërbimeve përmes teknologjisë. Janë shumë zyrtarë që kanë shkuar në ndjekje penale, janë shumë të tjerë janë larguar nga puna, e disa të tjerë janë paralajmëruar për përjashtim nga puna, tha Rama.

le me mbi faturimin, diplomat, probleme nga ata që hera-herës kthehen në pamundësi për njerëzit, ku në një zyrë duhet të marrin atë që u takon ngecin. Platforma është transformimi i shërbimeve përmes teknologjisë. Janë shumë zyrtarë që kanë shkuar në ndjekje penale, janë shumë të tjerë janë larguar nga puna, e disa të tjerë janë paralajmëruar për përjashtim nga puna, tha Rama.



Kryeministri Edi Rama dje në Kukës

## Faturimi i biznesit, Tabaku: Tenderi 15 mln euro. Ahmetaj: S'ka kosto shtesë

Për PD-në, paralajmërimi i saj 5 javë më parë, se monopoli e kontrollit të faturimit mbi biznesin do ta fitojë një kompani kroate, është faktuar tashmë. Sipas deputetës së PD-së Jorida Tabaku kompania kroate mori tenderin korruptiv dhe të paracaaktuar, që do të faturojë biznesin me një kosto nga 80-100 milionë euro. Edhe kreu i PD-së Lulzim Basha përsëriti dje akuzat e drejtuara më herët nga deputetët Jorida Tabaku dhe Endri Hasa për tenderin e faturimit të bizneseve, për kryeministrin Edi Rama. Basha deklaroi se ky tender është korruptiv dhe sipas tij i lidhur me vëllain e kryeministrin Edi Rama, Olsi Rama. Sipas tij Olsi Rama është ndihmuar nga një zyrtarë e huaj që ka shërbyer deri pak kohë më parë në Tiranë, por nuk ka përmendur emrin e saj. "Faturimi i bizneseve, tender korruptiv për Olsi Ramën. Një kompani kroate ka marrë tender kundër ligjit. Firma ka mbështetur nga një zyrtarë e huaj që ka shërbyer në Tiranë. Bashkëpunimi i Olsi Ramës me një shtetase të huaj që ishte deri para pak kohësh në Shqipëri, një firmë kroate ka fituar një tender prej miliona eurosh për menaxhimin e kasave fiskale. Kjo është një dhuratë e kryeministrin për vëllain tij. Mekanizmi i gjetur në këtë rast vetëm faktton vërtetësinë e akuzave që i kemi bërë publike. Flamuri i kuq, drita e kuqe indikator kryesor që tregon se është një tender i korruptiv është kur fitohet në kufijtë e cmimit limit. Nuk do mjaftohemi me këtë denonim", - u shpreh z.Basha. Për më poshtë në "Facebook", ministri i Ekonomisë dhe Financave Arben Ahmetaj i është përgjigjur akuzave të PD se me sistemin e ri do shtohen kostot për biznesin. PD u shpreh se monopoli e kontrollit të faturimit mbi biznesin do ta fitojë një kompani kroate, por ministri ka thënë se nuk do ketë asnjë kosto shtesë për biznesin dhe sipas tij koha e SHQUP-it ka mbaruar. "Do të ulë kostot e rënda të sistemit aktual që kemi trashëguar nga koha kur SHQUP-i imponoi kasa me kosto të paktën 300 euro vetëm për instalimin, pa folur për mirëmbajtjen, por që sidoqoftë nuk do të jetë aspak kusht që të dalin nga funksioni"-theksoi ministri Ahmetaj.

## Basha deklaroi se ky tender është korruptiv dhe sipas tij i lidhur me vëllain e kryeministrin Edi Rama, Olsi Rama.

Permbaresi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shtitje ne anand pasurine :  
a)Toka are e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 14425 ne Zonen Kadastrale 3217 me nr prone volumi 2, Fq 195, me sip totale 1937 m2 e ndodhur ne fshatin Rrashkullaj , Gruemirev , Malsi e Madhe . Cnimi per hapjen e ankandit eshte ne vleren 292,874 leke .  
b) Trulli + Ndertese e regjistruar ne regjistrin hipotekore me nr pasurie 15327 ne Zonen Kadastrale 3217, me nr prone Volumi 2, Fsqe 195 me sip totale 1900 m2, nga kjo Trulli 200 m2 , Ndertese 50 m2 e ndodhur ne lagjen Rrashkullaj Gruemire , Malsi e Madhe . Cnimi per hapjen e ankandit eshte ne vleren 199,180 leke  
Shitja e pasurise do te behet ( zhvillimet ) me date 05.11.2018 ora 16.16 ne Zyren e permbaresit gjyqësor Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Porballo Gjyqates se rrethit Gjyqësor Shkodër . Personat e interesuar duhet te derdhen parapara fillimit te ankandit 10% te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkodër me nr logarie 41064051.



Kryebashkiaku i Tiranës: "The Guardian" na thotë se ky qytet u zgjua nga letargjia

# Xhafaj, fushatë për mandatin e dytë të Veliajt: I flet vetë puna

"Puna dhe rezultatet, treguesi më i mirë për cilindo"

Ish-ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj u shfaq dje për herë të parë në publik në krah të Erion Veliajt për t'i dhënë atij mbështetje për një mandat tjetër në krye të bashkisë së Tiranës. Gjatë një takimi në njësinë numër 10 të Tiranës, Xhafaj-Veliaj dolën përkrah, duke vijuar fushatën elektorale, pavarësisht se zgjedhjet për kryetar bashkie duan edhe pak muaj.

Katër vjet më parë na është dashur të flisnim se kush është Erion Veliaj, kurse sot nuk na duhet fare të flasim sepse ai dhe ekipi i tij duhet të tregojnë çfarë punësh kanë bërë dhe janë duke bërë. Puna dhe rezultatet janë treguesi më i mirë, CV-ja më e mirë për cilindo.

Erion Veliaj hyri për një mision dhe me punë, me rezultate, me atë çfarë ka bërë, është duke kërkuar një mandat të dytë, jo për të vazhduar të qendrojë në atë karrige, por për të shërbyer dhe për ta çuar përpara këtë mision.

Gjëja më e mirë e tij është puna", deklaroi Xhafaj.

Nga ana tjetër, kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj gjatë këtij takimi foli dhe për artikullin e "The Guardian", të cilin e quajti si një dëshmi se energjia me të cilën kryhen punët e qytetit po vlerësohet gjithnjë e më shumë. Nga dëgjesa me banorët e Njësisë 10 për Buxheti 2019, e zhvilluar në mjediset e rikonstruktura të shkollës "Qemal Stafa", Veliaj tha se që punët e mira të vazhdojnë për Tiranën, është jetike shumica në Këshillin Bashkiak, ndaj është e nevojshme që në zgjedhjet e radhës, vota të shkojë për Partinë Socialiste.

"Gazeta prestigjioze "The Guardian" publikoi një shkrim special për Tiranën, për mënyrën si kanë ndryshuar gjërat në qytetin tonë. Një nga gjërat që vihet re në mënyrë sistematike është ky qytet. Në Tiranë ka plot punë për të bërë, por "The Guardian" dhe shumë media kritike po na thonë se ky qytet, pas zgjimit nga letargjia 4-vjeçare, sot është më i mirë", tha ai. Prandaj, "na duhet sot një shumicë në Këshillin Bashkiak, ashtu si kemi një shumicë në Parlament. Buxheti që po diskutojmë duhet të kalojë në Këshillin Bashkiak, në të cilin sot fatkeqësisht nuk



Ish-ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj dhe kryebashkiaku Erion Veliaj, dje në njësinë nr. 10

në kryeqytet të mos ndalet. Për të ilustruar rëndësinë e votës, Veliaj solli rastin e suksesshëm të rikonstruksionit të gjimnazit "Qemal Stafa" në kryeqytet, ku falë mbështetjes së qytetarëve investimi po përthohet edhe në cilësi në arsim.

"Ky është realiteti një nga ata shembuj që duhet ta përdorim për të thënë: Po, ky investim ka duk! Në goftë se dikush mendon se vota nuk vlen, ja ku është rasti konkret që voton për të bërë një punë, e cila sjell këtë rezultat", theksoi Veliaj.

Në dëgjësën me banorët e Njësisë 10, Veliaj listoi edhe një sërë investimesh të rëndësishme që kanë transformuar tërësisht zonën. "Kemi ndërhyrë në dy blloqe: rehabilituam hapësirën publike të Rruga e Durrësit, zona rreth bustit të "Adem Jasharit" dhe rikualifikuam zonën midis rrugëve "Sami Frashëri" dhe Bulevardit "Gjergj Fishta", gjithë zonën mbrapa Shallvareve dhe tregut Çam.

Kemi bërë asfaltimin e plotë të Rr. "Mujo Ulqinaku" dhe Rr. "Him Kolli", vendosëm sinjalistikë horizontale e vertikale për gjithë lidhjet e Unazës së Vogël dhe Unazës së Mesme të Tiranës", tha Veliaj, ndërsa bëri të ditur se është vendosur sinjalistika e plotë në 30 rrugë të kësaj njësie dhe është bërë asfaltimi dhe sistemimi në 45 rrugë të tjera", deklaroi ai.

## "PARKU RINIA"

Bashkia e Tiranës do të nisë një projekt të veçantë për rehabilitimin e Parkut "Rinia", për ta kthyer në një tjetër xhevahir të kryeqytetit. "Ka ardhur koha që siç kemi bërë Parkun e Liqenit me një cilësi shumë të lartë, siç janë bërë parqet e sheshit "Skënderbej", edhe parku "Rinia" ku zbarkon e gjithë Njësia 10, Rr. "Myslym Shyri" dhe zona e Postës të trajtohet me të njëjtën cilësi", tha ai.

kemi shumicën absolute. Jam i sigurt se ata të opozitës do të vijnë në ditën e votimeve, por duhet t'i pyesim: Ej, ku keni qenë? Pse keni tre vjet që nuk shkonin në mbledhjet e Këshillit Bashkiak, që nuk votoni ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar, që nuk votoni kompensimin e energjisë, banesat sociale,

bonusin e qirasë për familjet që s'përballojnë dot çmimet e tregut? Pse keni tre vite që nuk votoni asgjë në Bashkinë e Tiranës?", deklaroi Veliaj.

Ndërkaq, kryebashkiaku i Tiranës u bëri thirrje qytetarëve që në zgjedhjet e ardhshme të mbështesin maksimalisht PS, si e vetmja mënyrë që ritmi i punëve

## ARTIKULLI

"Gazeta prestigjioze "The Guardian" publikoi një shkrim special për Tiranën, për mënyrën si kanë ndryshuar gjërat në qytetin tonë. Një nga gjërat që vihet re në mënyrë sistematike është sa i sigurt është ky qytet. Në Tiranë ka plot punë për të bërë, por "The Guardian" dhe shumë media kritike po na thonë se ky qytet, pas zgjimit nga letargjia 4-vjeçare, sot është më i mirë".



## Kryemadhi takon ministrin kinez: Të nxisim bashkëpunimet rinore

Kryetarja e LSI znj. Monika Kryemadhi zhvilloi një takim me z. Song Tao, ministër, Drejtues i Departamentit Ndërkombëtar të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Kineze. Gjatë takimit u formalizuan marrëdhëniet ndërmjet dy partive, të cilat u vlerësuan si tepër të rëndësishme për të forcur më tej marrëdhëniet kino-shqiptare. Kryemadhi shprehu falënderimet dhe mirënjohjen për këtë hap të ri të hedhur ndërmjet dy partive dhe shprehu angazhimin për të shtrirë bashkëpunimin në disa fusha të rëndësishme të bashkëpunimit dypalësh, në fushat e Turizmit, Bujësisë, Infrastruktura dhe Drejtësisë e Rendit. Kryemadhi shprehu kënaqësinë për trendin në rritje të shkëmbimeve ekonomike-tregtare, ku sot Kina është investitori i dytë më i madh në Shqipëri, si dhe rritjen e vazhdueshme të numrit të turistëve kinezë në Shqipëri. Z. Song shprehu vlerësimin për bashkëpunimin me LSI si një faktor i rëndësishëm në politikën shqiptare dhe kontributore e përmirësimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve mes dy vendeve. Z. Song shprehu angazhimin, në emër të Partisë Komuniste Kineze, për të shtuar bashkëpunimin duke shkëmbyer takime të niveleve të larta për të ndarë eksperiencat e suksesshme respektive. Gjithashtu, një vëmendje e veçantë do i kushtohet shkëmbimeve rinore, në kuadër të forcimit dhe trashëgimit të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve. Znj. Kryemadhi vlerësoi arritjet e RPK dhe Presidentit Xi Jinping dhe zhvillimet pas Kongresit të 19, veçanërisht objektivat për luftën kundër varfërisë, rritjen e transparencës dhe zhvillimin e gjelbër. "Është e evidente që reformat kanë nxitur hapjen e Kinës dhe hapja ka nxitur më tej reformat duke sjellë zhvillim dhe stabilitet", u shpreh Kryemadhi.

## Shoqëria perparimorë JUSTITIA

Shoqëria perparimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza II, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna:  
 Truall - Ndërtuesi me sip. totale prej 250 m<sup>2</sup>, nga ku truall 250 m<sup>2</sup>, dhe ndërtuesi 101 m<sup>2</sup>, nr. pasurisë 9/383, Vll. 16/lq, 101, zona kadastrale 8532 me adresë L. "Sheq i Madh" Fier, e regjistruar në emër të Enver Demir Buzi  
 Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 3.276.000 (tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë.  
 Ankand zhvillohet në datën 30.11.2018, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbuesit gjyqësor, me adresë Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890



REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
 BANKA E SHQIPËRIE  
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
 SEKTORI I PROKURIMIT

## TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Blerje pajisje dhe aksesorë të sistemeve të mbrojtjes elektronike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 3,718,400 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë parapraçitjes pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
 BIC: STANALTR  
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Blerje pajisje dhe aksesorë të sistemeve të mbrojtjes elektronike për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 03 Dhjetor 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

3 mastera të rinj profesionalë me profil ekonomik, degë e re në Financë dhe Menaxhim Risku

# Universiteti "Luarasi": Ja kur mbyllen aplikimet në bachelor e master

## "Kriteret dhe dokumentacioni që duhen plotësuar"

Voltiza Duro

Universiteti "Luarasi" po vazhdon regjistrimet për të gjithë ata që dëshirojnë të ndjekin studimet në një prej programeve në nivelin bachelor apo master. Të interesuarit mund të aplikojnë për një nga degët e studimit në këtë institucion elitare të arsimit të lartë deri në 2 nëntor të këtij viti, ndërkohë që procesi i regjistrimeve do të vijojë deri në 7 nëntor. Bazuar në udhëzimin e MASR-së Nr. 33, datë 23.10.2018 ju njoftojmë se kandidatët për studentë të cilët nuk kanë mundur të aplikojnë apo të regjistrohen gjatë raundeve të para (përfshi këtu dhe studentët që nuk e kanë plotësuar formularin A1 / A1Z) mund të aplikojnë deri në datë 2 nëntor 2018. Ndërsa procesi i regjistrimeve do të vazhdojë deri në datën 5-7 nëntor 2018", thuhet në njoftimin e universitetit "Luarasi". Ndërkohë në rast se do të ketë ende kuota të lira në një prej degëve në 3 fakultetet e "Luarasi-t", regjistrimet do të vazhdojnë deri në datë 15 nëntor 2018.

### KRITERET

Maturantët që dëshirojnë të ndjekin studimet e larta në një prej 3 fakulteteve që ofron "Luarasi" duhet të plotësojnë disa kriteret. Se pari, të interesuarit duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të zotërojnë diplomën e shkollës së mesme ku kanë përfunduar studimet. Gjithashtu, kandidatët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare mbi 6 (përfshihen këtu studentët që aplikojnë për studime të larta profesionale); si dhe nuk duhet të rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi.

### DOKUMENTACIONI

Të interesuarit mund të paraqesin pranë sekretarisë mësimore të universitetit "Luarasi" dokumentacionin e përcaktuar. Respektivisht kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të noterizuar të diplomës së shkollës së mesme (e njëjësuar nga MASR në rast se studenti ka mbaruar jashtë vendit); një kopje të mjetit të identifikimit; si dhe dy fotografi. "Mos hezitoni të na kontaktoni për pyetje apo paqartësi lidhur me procesin e pranimit në të gjitha programet dhe ciklet e studimit që ofron KU "Luarasi". Ju mirëpresim!", thuhet më tej në njoftim.

### PROGRAMET MASTER

Për herë të parë Luarasi do të ofrojë programe jo vetëm për ciklin e parë të studimeve bachelor në fushën e teknologjisë, por edhe në ciklin e dytë master. Për vitin e ri akademik 2018-2019, universiteti do të ofrojë masterin profesional për Sigurinë Kibernetike dhe Informacionin si dhe masterin shkencor për Teknologjinë e Informacionit dhe Inova-



### KRITERET E APLIKIMIT

Maturantët që dëshirojnë të ndjekin studimet e larta në një prej 3 fakulteteve që ofron "Luarasi" duhet të plotësojnë disa kriteret. Se pari, të interesuarit duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të zotërojnë diplomën e shkollës së mesme ku kanë përfunduar studimet. Gjithashtu, kandidatët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare mbi 6 (përfshihen këtu studentët që aplikojnë për studime të larta profesionale).

### KRITERET DHE DOKUMENTACIONI

**Aplikimi mund të kryhet nga ata maturantët që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:**

- > Zotërojnë diplomën e shkollës së mesme ku kanë përfunduar studimet;
  - > Plotësojnë kriterin e notës mesatare mbi 6 (përfshihen këtu studentët që aplikojnë për studime të larta profesionale);
  - > Nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi.
- Dokumentet e nevojshme për regjistrim janë:**
1. Kopje të noterizuar të diplomës së shkollës së mesme (e njëjësuar nga MASR në rast se studenti ka mbaruar jashtë vendit);
  2. Kopje të mjetit të identifikimit;
  3. Dy fotografi;

3

### MASTERA PROFESIONALE NE EKONOMIK

Për t'u gjendur sa më pranë studentëve, institucioni elitare i arsimit të lartë ka çelur 3 mastera profesionalë në Fakultetin Ekonomik për vitin e ri akademik 2018-2019. Përkatesisht tri degët e reja në ciklin e dytë të studimeve janë Marketing dhe Reklamë, Financë dhe Menaxhim Risku si dhe Kontabilitet.

2

### MASTERA NE FAKULTETIN E RI

Për herë të parë "Luarasi" do të ofrojë programe jo vetëm për ciklin e parë të studimeve bachelor në fushën e teknologjisë, por edhe në ciklin e dytë master. Për vitin e ri akademik 2018-2019, universiteti do të ofrojë masterin profesional për Sigurinë Kibernetike dhe Informacionin si dhe masterin shkencor për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacionit.

cionit. Këto programe kanë për qëllim të sigurojnë një lidhje organike mes teknologjisë së informacionit dhe biznesit. Në mbarim të këtij cikli të diplomuarit do të kenë mundësi jo vetëm të identifikojnë nevojat e bizne-

sit, por të propozojnë edhe zgjidhje mbështetur në këto teknologji të kohës. Universiteti "Luarasi" po i afrohet këto ditë e më shumë nevojave të tregut duke përgatitur profesionistë në programet më të kërkuara aktu-

alisht. Për t'u gjendur sa më pranë studentëve, institucioni elitare i arsimit të lartë ka çelur 3 mastera profesionalë në Fakultetin Ekonomik për vitin e ri akademik 2018-2019. Përkatesisht tre degët e reja në ciklin e dytë të stu-

dimeve janë Marketing dhe Reklamë; Financë dhe Menaxhim Risku si dhe Kontabilitet. Fakulteti Ekonomik në universitetin "Luarasi" ofron për studentët edhe dy mastera shkencorë shumë të rëndë-

sishëm; përkatesisht për Banka dhe Tregje Financiare dhe Menaxhim Ekzekutiv. Spaho thekson se edhe masteri profesional Menaxhimi i sigurimeve, i çelur një vit më parë ka rezultuar i suksesshëm.

## Ministria Manastirliu: Vlerësoj maksimalisht mbështetjen

### Italia ofron ndihmë për trajtimin e pacientëve me hemofili në Shqipëri

Të sëmuret me hemofili në vendin tonë tashmë do të kenë mbështetjen e shtetit italian për trajtimin e sëmundjes. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ogera Manastirliu mori pjesë dje në një tryeze pune në Senatin Italian, për shkëmbimin e eksperiencave dhe bashkëpunimin mes vendeve për sëmundjet e lindura të gjakut.

"Jetëgjatësia dhe trajtimi i pacientëve me hemoglobinopati ka ndryshuar cilësisht vitet e fundit në Shqipëri, por kemi ende shumë për të bërë sa i takon

profilaksisë dhe identifikimit të hershëm të sëmundjeve të lindura të gjakut", tha Manastirliu në fjalën e saj. Ajo më tej vlerësoi mbështetjen e Italisë për të siguruar ndihmë konkrete për sigurimin e faktorit VIII, i cili është jetik për të sëmuret hemofilikë. Seanca drejtohej nga Pier Paolo Sileri, president i Komisionit të Shëndetësisë në Senatin Italian, ku merret pjesë, gjithashtu, edhe nënsekretari i shtetit, Armando Bartolazzi, zëvendës sekretar i Ministrisë së Shën-



detësisë në Itali. Me Bartolazzi, më herët, Ministria Manastirliu zhvilloi një takim zyrtar, ku palët u dakordësua

an për forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ndërsjellët midis Shqipërisë dhe Italisë për shën-

detin publik, në fushën farmaceutike, bashkëpunimin mes spitaleve, edukimin dhe trajnimin e mjekëve. Bashkëpunimi do të formalizohet me marrëveshjen e re mes dy vendeve tona, e cila pritet të firmoset së shpejti nga ministrat respektivë të Shëndetësisë. Takimet e zhvilluara në Itali, janë në kuadër të projekteve të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e sëmundjeve të lindura të gjakut, ku Shqipëria është përfutuese e faktorëve antikoagulues.



## LOTARIA AMERIKANE KËSHILLAT

Voltiza Duro

Të gjithë ata që dëshirojnë të jetojnë e punojnë në tokën e premtuar, kanë edhe 7 ditë kohë për aplikimin për lotarinë amerikane. Ambasada amerikane në Tiranë, jep këshillat e fundit për aplikantët që do të plotësojnë formularin. "Plotësojeni vetë formularin tuaj. Lexoni në sqip udhëzimet e Lotarisë Amerikane për këtë vit. Mos vendosni si bashkëshort/e dikë që nuk është akoma bashkëshorti/ja juaj në ditën që po aplikoni për lotarinë pasi kjo ju skualifikon", theksohet në njoftimin e ambasadës amerikane. Ndërkohë mosdeklarimi i bashkëshortit/es ekzistues, apo i fëmijës ekzistues në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë do të rezultojnë në refuzimin e vizës. Çdo tarifë e paguar ndaj qeverisë së Shteteve të Bashkuara për aplikimin për vizë nuk rimbursohet. Nëse në momentin e aplikimit fillestar, nuk keni përfshirë një fëmijë ekzistues, apo një bashkëshort/e me të cilën ishit i martuar (pra, statusi civil ishte "i martuar" në momentin e aplikimit fillestar), atëherë mos vazhdoni me procedurën e aplikimit për vizë.

### KUSHTET

Të gjithë aplikantët e lotarisë së Vizave të Shumëllojshmërisë (DV) këshillohen të shqyrtojnë udhëzimet mbi kriteret e kualifikimit të arsimimit dhe punësimit para se të aplikojnë. Aplikanti kryesor (ai që është përzgjedhur në bazë të numrit të aplikimit) duhet të ketë arsimim apo punësim të kualifikueshëm me qëllim që të kualifikohet për një vizë të programit të lotarisë së DV-së. Aplikantët duhet të kenë mbaruar arsimin e mesëm me kohë të plotë që është i barasvlefshëm me arsimimin në të paktën një shkollë të mesme amerikane (4 vjeçare, me kohë të plotë, arsim i përgjithshëm). Diplomat e shkollës së mesme gjinnaz me kohë të plotë kualifikohen për lotarinë. Shkollat e mesme profesionale me kohë të plotë mund të kualifikohen nëse ato në thelb përputhen me kërkesat thelbësore të një të arsimi të mesëm me kohë të plotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vendimi përfundimtar do të merret nga oficeri konsullor në ditën e intervistës për vizë. Diplomat e shkollës së mesme me kohë të pjesthme - pa shkëputje nga puna, shkollat e

Përzgjedhja e fituesëve do të bëhet nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Aplikimit

# Lotaria Amerikane, ambasada: Kujdes me deklarimin e statusit tuaj civil

"Tarifat e paguara për aplikimin për vizë nuk rimbursohen"



### KUSHTET E APLIKIMIT

Të gjithë aplikantët e lotarisë së Vizave të Shumëllojshmërisë (DV) këshillohen të shqyrtojnë udhëzimet mbi kriteret e kualifikimit të arsimimit dhe punësimit para se të aplikojnë. Aplikanti kryesor (ai që është përzgjedhur në bazë të numrit të aplikimit) duhet të ketë arsimim apo punësim të kualifikueshëm, me qëllim që të kualifikohet për një vizë të programit të lotarisë së DV-së.

natës ose ato me korrespondencë, përfshirë programet pesë vjeçare ose programet e gjata (me kohë të pjesthme, pa shkëputje nga puna, shkollat e natës ose me korrespondencë) nuk kualifikohen për programin e lotarisë. "Edhe nëse ju keni mbaruar një pjesë të shkollës së mesme në sistemin pa shkëputje nga puna dhe pjesën tjetër në sistemin me kohë të plotë, kjo diplomë nuk kualifikohet për programin e lotarisë", thotë ambasada. Diplomat universitare kualifikohen për programin e lotarisë së DV-së. Aplikantët që nuk përmbushin kriterin e arsimimit, duhet të përmbushin kriterin e përvojës në punë për dy vjet në një profesion që kërkon të paktën dy vjet trajnim apo përvojë brenda një periudhe

pesëvjeçare menjëherë para aplikimit. Vetëm disa profesione specifike kualifikohen për programin e Vizave të Shumëllojshmërisë. "Për t'u kualifikuar për një vizë të lotarisë mbi bazën e eksperiencës së punës, ju duhet të keni brenda pesë viteve të fundit dy vjet përvojë në një profesion që është përcaktuar si Zonë Pune 4 ose 5, e klasifikuar në Përgatitjen Profesionale Specifike (SVP) të vlerës 7.0 ose më lart", thekson Departamenti Amerikan i Shtetit.

### APLIKIMI

Përpara intervistës për vizë, aplikantët duhet të rishikojnë të dhënat që kanë dhënë në aplikimin fillestar për lotarinë. "Sigurohuni që të keni dhënë informacionin e saktë mbi statusin tuaj civil në momentin e aplikimit fillestar. Nëse ju ishit i/e

martuar në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë, ju duhet të kishit përfshirë bashkëshortin/en tuaj në atë aplikim fillestar (edhe nëse keni qenë në proces divorci). Përjashtim bëjnë rastet kur bashkëshorti është Nënshtetas Amerikan, ose Banor i Përhershëm i Ligjshëm. Gjithashtu, ju duhet të kishit përfshirë të gjithë fëmijët tuaj të pamartuar dhe nën 21 vjeç në momentin e aplikimit fillestar. Me fëmijë nënkuptohen fëmijët tuaj biologjikë, dhe thjeshtërit- fëmijët e bashkëshortit/es tuaj, apo fëmijë që i keni birësuar ligjrisht, pavarësisht nëse jetojnë me ju ose jo. Sigurohuni që ju keni ngarkuar fotografinë e saktë për çdo pjesëtar të familjes në momentin e aplikimit fillestar për lotarinë. Ngatërrimi i fotografive në aplikimin fillestar do të rezultojnë në refuzimin e vizës për ju dhe familjen tuaj", thotë ambasada.

### MASHTRIMET

"Nëse ju keni marrë një postë elektronike (e-mail) që ju njofton se aplikimi juaj për programin e Lotarisë Amerikane ishte fitues dhe në mënyrë që të vazhdoni me aplikimin tuaj ju duhet të dërgoni një shumë të hollash (para) në emër të një personi, ju jeni viktimë e një mashtrimi. Vitet e shkuara, aplikantët

Jo më nënshtetësi amerikane për fëmijët e huaj që lindin në SHBA

Presidenti Donald Trump ka njoftuar se po planifikon që të ndërpresë dhënien e shtetësisë amerikane për fëmijët e huaj që lindin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai tha se po punohet për t'i dhënë fund përmes një urdhri ekzekutiv dhënies së shtetësisë për fëmijët jo amerikanë. Trump tha se urdhri ekzekutiv nuk është e nevojshme që të votohet në Kongres. "Ne jemi i vetmi shtet në botë që një person vjen këtu, lind një fëmijë, dhe fëmija në thelb është një qytetar i Shteteve të Bashkuara për 85 vite duke pasur edhe përfitime. Është qesharake dhe kjo duhet që të marrë fund", tha Donald Trump.



fitues njoftoheshin nga Departamenti i Shtetit, Qendra Konsullore në Kentucky (QKK) me anë të postës, JO me e-mail dhe të përzgjedhurve u jepeshin udhëzimet se si të vazhdonin në hapat e mëtejshëm të procesit. QKK-ja nuk ju kërkon juve t'u dërgoni para (të holla) atyre, apo ndonjë Ambasade tjetër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SH.B.A.) me postë apo nëpërmjet shërbimeve si Western Union", -bën me dije ambasada. Vetëm aplikantët e përzgjedhur njoftohen nga Departamenti i Shtetit, Qendra Konsullore në Kentucky (QKK). Asnjë organizatë tjetër apo kompani private nuk është e autorizuar nga Departamenti i Shtetit për të njoftuar aplikantët e DV-së për përzgjedhjen e aplikimit të tyre si fitues, apo të hapave të mëtejshëm në procesimin e aplikimit për vizë.

### PËRZGJEDHJA

Për ata që kanë aplikuar për Programin e Lotarisë DV-2020, njoftimi zyrtar i përzgjedhjes do të kryhet drejtpërdrejt nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Aplikimit (Entrant Status Check). Kjo është e vetmja

mënyrë me të cilën do të merret njoftimi i statusit të aplikimit. "Nëse ju merrni një njoftim me anë të postës elektronike apo me postë rreth përzgjedhjes suaj në lotarinë E-DV, duhet të dini që ky njoftim nuk është i ligjshëm. Vetëm pasi ju të jeni përzgjedhur, pasi t'u jeni përgjigjur udhëzimeve të njoftimit të mundësuar për ju nëpërmjet Kontrollit të Statusit të Aplikimit, si dhe pasi të ketë filluar shqyrtimi i rastit tuaj, vetëm atëherë ju mund të merrni në vazhdim e-maile komunikimi nga QKK-ja që ju njofton juve të shikoni Kontrollin e Statusit të Aplikimit për informacione të reja rreth aplikimit tuaj. Për të përzgjedhurit e programit DV-2019, duhet të plotësojnë formularin elektronik DS-260. Sa më herët ta plotësoni formularin DS-260, aq më shpejt keni mundësinë e caktimit të datës së intervistës për vizë. Caktimi i datës së intervistës varet nga dy faktorë: 1. numri juaj, sa më i ulët - aq më shpejt intervista, dhe 2. sa më shpejt të plotësoni DS-260 - aq më shpejt intervista. Formulari DS-260 gjendet në faqen e internetit", -nënvizohet në faqen zyrtare të ambasadës.



Pas Rrugës së Kombit, pritet që rruga kryesore në vend të jepet me koncesion

# Tiranë-Durrës me tarifë, biznesi privat bën propozimin në qeveri

## Gjikhuri: S'ka vendim, jemi në fazën e analizës

**A**utostrada Tiranë-Durrës pritet të jepet me koncesion përmes një kontrate të tipit BOT, që nënkupton ndërtimin, operimin e më pas transferimin e saj tek autoritetet shtetërore. Ndërkohë që në këtë rast bëhet fjalë për zgjerim të saj, duke qenë se kjo vepër është tashmë e ndërtuar. Ndërkaq, përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë thanë për "TV SCAN" se tashmë është paraqitur një propozim, i cili po analizohet nga ky dikaster, ndërkohë që në vijim të analizimit dhe nëse do të merret në konsideratë, do të bëhen transparente të gjitha fazat e mëtejshme.

Të njëjtit përfaqësues shtuan se bëhet fjalë për një propozim, ku i gjithë investimi kryhet nga privati, ndërkohë që rruga kryesore parashikohet të jetë me pagesë. Referuar propozimi të mbërritur, kompania private angazhohet të sigurojë edhe rrugët dytësore, që do të jenë pa pagesë, duke iu mundësuar qytetarëve zgjedhje alternative. Sa i takon pagesës së kalimit, do të jetë kompania private, ajo që do të vendosë sesa do të jetë, duke marrë parasysh kos-

### PROCEDURAT

Referuar procedurave standarde, në rastin e propozimeve të pakërkuara, fillimisht ato miratohen nga Këshilli i Ministrave, i cili akordon edhe një bonus pikësh për kompaninë që e ka paraqitur, ndërsa më pas hapet një garë zyrtare pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, ku mund të dorëzohen oferta të gjitha kompanitë e interesuara.



### REAGIMI I QEVERISE

Projektet e paraqitura kanë për referencë kosto tavan dhe jo kosto konkrete të realizimit. Kostot finale të projekteve përcaktohen vetëm pasi të ketë projekt zbatim të miratur për realizimin e veprave në fjalë. Çdo koment mbi shifra konkrete në këtë fazë është keqinformim dhe spekulim mediatik.

ton e investimit dhe fitimin e saj.

Referuar procedurave standarde, në rastin e propozimeve të pakërkuara, fillimisht ato miratohen nga Këshilli i Ministrave, i cili akordon edhe një bonus pikësh për kompaninë që e ka paraqitur, ndërsa më pas hapet një garë zyrtare pranë Agjencisë së

### DAMIAN GJIKNURI

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë informon opinionin publik se në këtë institucion është depozituar një propozim nga një subjekt privat për realizimin e projektit të zbatimit, financimit, zhvillimit dhe operimit e projektit sipas kornizës së PPP në modelin BOT, për segmentin rrugor: Segmenti 1: Tiranë-Vorë-Durrës Segmenti 2: Kashar-Rrogozhinë

Prokurimit Publik, ku mund të dorëzohen oferta të gjitha kompanitë e in-

teresuara. Fakti që autostrada Tiranë-Durrës do të bëhet me pagesë është

### REAGIMI I GJIKNKURIT

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë informon opinionin publik se në këtë institucion është depozituar një propozim nga një subjekt privat për real-

izimin e projektit të zbatimit, financimit, zhvillimit dhe operimit e projektit sipas kornizës së PPP në modelin BOT, për segmentin rrugor:

**Segmenti 1: Tiranë-Vorë-Durrës**  
**Segmenti 2: Kashar-Rrogozhinë**

Propozimi ka për qëllim të ofrojë një zgjidhje të qëndrueshme për të ulur ngarkesën në të gjithë rajonin Tiranë, Durrës dhe Rrogozhinë. Skema e propozuar parashikon ndërtimin e veprave në fjalë në dy faza. Së pari, zgjerimin e aksit Tiranë-Vorë-Durrës, rehabilitimin e rrugës dytësore Tiranë-Durrës përmes Ndroqit dhe asaj të aksesit për bizneset. Së dyti, në një fazë të mëvonshme, përtej 2025, parashikohet ndërtimi i aksit tjetër Kashar-Rrogozhinë. Skema e propozuar parashikon që të gjithë koston e ndërtimit e përballon koncesionari privat, i cili vendos një tarifë për kalimin duke garantuar shlyerjen e investimit dhe fitimin e arsyeshëm pa rënduar mbi Buxhetin e Shtetit. Qytetarëve u krijohet edhe mundësia e kalimit pa pagesë përmes rrugës alternative. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është duke analizuar këto propozime, nuk ka asnjë vendimimarrje dhe në rast të një konkluzioni pozitiv, do të ndiqen me transparencë të plotë të gjitha procedurat e përcaktuara në ligj, duke garantuar mbrojtjen maksimale të interesave të qytetarëve shqiptare.

## "Monitor": 72 kilometra autostradë Thumanë-Vorë-Rrogozhinë

### Qeveria projektin të financojë rrugën me rreth 900 milionë euro

**A**utostrada Thumanë-Kashar-Rrogozhinë do të jetë projekti më i kushtueshëm pas Rrugës së Kombit, pasi qeveria ka programuar të financojë punimet e saj nëpërmjet kontratës me koncesion Publik-Privat me 113 miliardë lekë (rreth 900 milionë euro) për 72 kilometra, sipas të dhënave nga Ministria e Financave.

Projekti është i ndarë në dy segmente. I pari që përfshin ndërtimin e 20 kilometrave të para, për përfundimin e të cilëve, qeveria ka pranuar propozimin e pakërkuar nga kompania "GENER 2" kundrejt vlerës 225.8 milionë euro. Negociimi i kontratës ndërmjet koncesionarit dhe kompanisë është në proces dhe punimet pritet të nisnin vitin që vjen. Ndërsa segmenti i dytë Kashar-Rrogozhinë është programuar të financohet me mbi 84 miliardë lekë, gjithash-



tu nëpërmjet kontratës koncesionare PPP, procedurat e së cilës janë në nisje, duke e çuar koston totale të projektit në 113 miliardë lekë (893 milionë euro).

Kosto për kilometër e projektit arrin në 12,4 milionë euro. Një raport i

Bankës Islamike, që është financues i rrugëve në Shqipëri, llogarit më herët se kostoja e Thumanë-Rrogozhinë ishte 320 milionë euro në 72 kilometrat e saj. Me koncesionin PPP, koston gati trefishohet. Në fund të viteve 2000, qeveria shqiptare renditi si prioritet

një autostradë në pjesën qendrore të vendit, përkatësisht në Thumanë-Rrogozhinë për të lidhur autostradën e re të veriut me jugun, sipas një varianti më të shkurtër dhe për të shmangur trafikun në këtë zonë të ngarkuar tashmë. Pjesa e parë e këtij segmenti prej 20 kilometrash, Thumanë-Kashar, u përfshi në 13 projektet parësore të strategjisë sektoriale të transportit për periudhën 2016-2020. Dokumenti që ka marrë miratimin e qeverisë parashikonte një kosto 92 milionë euro për 20 kilometra të para, por dy vite më vonë nga strategjia në fuqi, qeveria shqiptare e kontraktoi segmentin për ndërtimin nëpërmjet koncesionit me PPP kundrejt 225 milionë eurove. Koncesionin e fitoi kompania "Gener 2", pasi bëri ofertën më të ulët. Kostoja me të cilën do të ndërtohet rruga është 2,5 herë më

e lartë se parashikimi i qeverisë në dokumentin që vetë miratoi vitin e kaluar. Ekspertët e sektorit vlerësuan se kjo është shumë e lartë, pasi autostrada kalon në një pjesë fushore, ku disa pjesë të segmentit janë të shtruara. Ndërsa veprat e artit janë katër kilometër ura dhe tri nyje nënkalmesh dhe mbikalimesh. Sipas këtyre rezultateve, Shqipëria futet ndër vendet me kosto të larta në ndërtimin e rrugëve. Sipas vlerësimit të "World Highways", koston më të lartë të ndërtimit të autostradave për 1 kilometër e ka Austria me mbi 12 milionë euro për kilometër, Hungaria me 11 milionë euro dhe Gjermania me mbi 8 milionë euro. Kostoja e lartë e këtyre autostradave në këto shtete vjen nga terreni i vështirë për shkak të zonave malore. "Monitor"

Aleksandër Tanushi: E fal hajdutin që arrestoi policia, shpresoj ta shoh në kishë si besimtar

# Vodhi paratë e dëmtoi Kishën Françeskane, 26-vjeçari kapet në një lokal duke pirë raki

## Përgjegjësi i objektit të Kultit: E kapa brenda, më kërkoi mëshirë dhe pastaj më iku nga duart

SENAD NIKSHIQI

SHKODËR

Një 26-vjeçar zgjodhi të futet në Kishën Françeskane në Shkodër për të vjedhur para. Kristian Arra nuk e ka menduar shumë mirë planin e tij, pasi ka arritur që të vjedhë vetëm 7 mijë lekë të vjetër dhe në fund ka përfunduar i arrestuar nga policia pas denoncimit që ka bërë përgjegjësi i Kishës Françeskane në Shkodër, Aleksandër Tanushi. Ky i fundit dje ka treguar për "Gazeta Shqiptare" edhe se si ka ndodhur kjo ngjarje. "Ngjarja ka ndodhur rreth orës 21:00 të 29 tetorit. Unë dua të jap një mesazh për opinionin, për besimtarët dhe të gjithë ata që janë shqetësuar për këtë ngjarje. Gjithmonë nga kisha është dhënë mesazhi i paqes dhe unë dua ta jap këtë mesazh pas kësaj ngjarjeje për plaçkitjet që është bërë në kishë. Nuk është bërë një dëm i madh, por gjithsesi ka qenë një person, i cili ka tentuar që të plaçkitë kishën, por nuk ka mundur që t'ia arrijë qëllimit, ashtu siç e ka planifikuar, sepse unë jam ndeshur me personin dhe ai më iku nga duart. Falënderoj policinë, e cila shumë shpejt arriti që ta arrestonte, por edhe kontrolli kudo deri tek kompanjeli ku mendoj se nga aty është futur, por edhe nga aty ka ikur pastaj", tha përgjegjësi i Kishës Françeskane.

### DËSHMIA E PËRGJEGJËSIT TË KISHËS

Më tutje Tanushi u shpreh se, "hajdutin me sa duket nuk i kanë interesuar pjesët sakrale që janë pikturat apo të tjera si këto, por gjatë kësaj tentative, disa trupore të Shna Ndout dhe tek truporja e Krishtit dhe Shën Françeskut me sa është parë ka tentuar që t'i hapë me mjete të forta, por ka kuptuar se arka e lëmshës ku hedhin para bamirësit ka qenë nën trupore. Ka prishur drynin dhe i ka hapur, por s'ka gjetur asgjë, sepse ne i kemi marrë më përpara, sepse nuk i lëmshëm aty", tregoi përgjegjësi i Kishës Françeskane në Shkodër, Aleksandër Tanushi. Gjithashtu, ky i fundit tregoi se si e ka mësuar se në kishë mund të ndodhë një hajdut. Tanushi pohoi se, "roja i parkingut përballë kishës më telefonoi dhe më tha se diçka nuk shkon në kishë dhe se dyshonte se ishte dikush brenda. Unë erdha dhe hapa dyert e kishës dhe e gjeta brenda. Erdhi tek unë menjëherë dhe më kërkoi mëshirë dhe nga biseda shumë e shkurtër me të m'u prezantua me emrin Kristian. Normalisht që fillimisht pata një lloj frike, sepse



Aleksandër Tanushi duke folur për "GSH"



Kisha Françeskane në Shkodër



"Nga strukturat e Hetimit të Krimin në Komisaratin e Policisë Shkodër në bashkëpunim me Forcën e Posaçme 'Shqiponjat' është arrestuar në flagrancë shtetasi Kristjan Arra, banues në lagjen 'Partizani' Shkodër, i dënua dhe më parë për 'Vjedhje'. Arrestimi i tij u bë, pasi në Kishën Françeskane, në lagjen 'Vasil Shanto' ka vjedhur një sasi lekësh, si dhe ka dëmtuar disa objekte të kultit fetar me vlerë të kësaj kishë. Materialet u referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër për veprat penale të 'Vjedhje' dhe 'Shkatërrimi i veprave kulturore'", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë së Shkodrës.

### ARRESTIMI

nuk e dija se kush mund të ishte tjetër me të apo nëse kishte mjete të forta apo edhe armë. Nga biseda që pata, ai më tha 'të lutem mos e thirr policinë' dhe kur unë nxora telefonin për të njoftuar policinë ai më iku nga duart sepse unë e kisha kapur", vijoi Tanushi. Në përgjegjësi i kishës do të kërkohet mëshirë për hajdutin që arrestoi policia. "Personin nuk e kam parë asnjëherë në Kishën e tonë, por ka mbetur si figurë në mendjen time. Shpresoj që ta shoh sërish në kishë, por këtë radhë si besimtar që lutet. Kisha gjithmonë i fal njerëzit dhe patjetër që e kam falur dhe sot jam lutur në mënyrë të veçantë për të dhe për të gjithë personat që mendojnë të bëjnë një veprim të tillë në kisha apo xhamia apo edhe në prona familjare që të mos ndodhin gjëra të tilla. Ne do të lutemi për paqe, harmoni dhe sukses në familje, në mënyrë që ky fenomen të zhduket dhe kërkohet mëshirë prej Zotit që t'i ndihmojë këta persona që të largohen nga veprimet e tilla", përfundoi përgjegjësi Tanushi. Policia arriti ta identifikojë dhe ta arrestojë shpejt autorin e vjedhjes, ndërsa sipas burimeve, ai në momentin e arrestimit ndodhej në një lokal në qytetin e Shkodrës duke pirë.

### KPK: Rezulton pa probleme, justifikon pasurinë

## Prokurori i "Gërdecit", Sokol Stojani i nënshtrohet procesit të vetingut

TIRANE - Sokol Stojani, prokurori që drejtoi grupin e hetimit për çështjen "Gërdecit", ku asokohe i pandehur u mor edhe ish-ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu, doli dje në seancën dëgjimore përpara institucioneve të vetingut. Nga hetimi i thelluar administrativ i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, prokurori i karrierës rezultoi pa probleme në të tria shtyllat e kontrollit. Relatorja e çështjes tha se ILDKPI konfirmonte se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë në përputhje me ligjin, ka burime financiare për të justifikuar pasurinë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit. Si pasuri të Stojanit u listuan një apartament i blerë në vitin 2002 me kredi, si dhe një automjet me vlerë 4 mijë euro. Në sitën e kon-



trollit të trefishtë kanë kaluar edhe familjarët e prokurorit, të cilët gjithashtu e kanë justifikuar pasurinë me burime të ligjshme. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar konfirmonte përshtatshmerinë e prokurorit në detyrë, për shkak se nuk ishin gjetur lidhje të tij me eksponentët të kimit të organizuar. Në shtyllën e aftësive profesionale, Sokol Stojani

kishte marrë vlerësime pozitive, ndërsa në emër të tij ishin paraqitur shtatë ankesa, njëra prej të cilave nga ish-ministri i Mbrojtjes, Fatmir Mediu. Asnjëra prej ankesave nuk kishte gjetur bazë ligjore. Pasi u njoh me gjetjet e komisionit, prokurori Stojani kërkoi konfirmimin në detyrë. Vendimi për të pritë të shpallet të mërkurën e 31 tetorit.

### Fund kalvarit në gjyq, çelet konkursi për gradat në polici

TIRANË - Punonjësit e policisë që kanë më shumë se 5 vite në gradën ekzistuese tashmë mund të konkurrojnë për ta rritur atë paqenë e nevojshme të shkojnë në Gjykatë Administrative. Me anë të një urdhri të drejtorit të përgjithshëm të policisë, Ardi Veliu që mban datën 29 tetor 2018 është hapur gara për gradën "Komisar" e "Kryekomisar" dhe së shpejti edhe për gradën "Drejtes". Prej vitit 2012 nuk është hapur konkurs për këto grada në Akademinë e Policisë, duke detyruar kështu që të gjithë policët që i plotësonin kriteret t'i drejtoheshin gjykatës, e cila ua jepte automatikisht gradën më të lartë. Testi me shkrim për të fituar gradën "Komisar" dhe "Kryekomisar" do të zhvillohet në Akademinë e Policisë në orën 7.30 në datat 7 dhe 12 nëntor. Çdo drejtori policie dhe komisarati është i detyruar të njoftojë gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret. Kandidatët duhet të paraqiten ditën e konkurimit me kartën e identitetit dhe me mjetin identifikues si punonjës policie. Rezultatet e konkurimit dalin brenda ditës dhe i gjithë procesi monitorohet nga Aida Hajnaj, zëvendës-drejtoresha e Përgjithshme e Policisë. E njëjta procedurë do të zgjidhet edhe për gradën "Drejtes", por data e konkurimit ende nuk është përcaktuar.

# VIP

Suplement  
*Pages*

Emërkurë 31 Tetor 2016

GAZETA SHQIPTARE

## "BULEVARDI POLITIK"

- Ndaloj me urdhër celularët, ministrja s'e lëshon nga dora...
- Ministri romantik, publikon fotot e gruas për të promovuar '100 fshatrat'
- Trump 'nuk di' si mbyllet çadra, video virale në rrjet
- Djali i Bashkim Finos martohet me vajzën e zyrtarit të LSI

Publikoi klipin me veshje provokuese, Rovena shfaqet edhe pa të brendshme



Noizy e tepron me fotoshopin, fansat tallen keq me këtë detaj në foto



Mike apo rivale? VIP-at që nuk komunikojnë me njëra-tjetrën



Konflikte apo inate? Cilat janë arsyet e zënies së njerëzve të famshëm

## Mike apo rivale? VIP-at që nuk komunikojnë me njëra-tjetrën

# Konflikte apo inate? Cilat janë arsyet e zënies së njerëzve të famshëm

**P**rej kohësh tashmë shohim që shumë prej miqve apo mike shave nuk flasin më me njëri-tjetrin. Kjo për shkak të inateve të brendshme apo edhe dicka tjetër. Kanë dalë publikisht duke thënë se janë mikeshë, madje shpesh kanë ndarë bashkë sekrete personale, por edhe thashetheme për të tjerët. Secili me suksese të veçanta dhe kontribute personale apo edhe më gjerë, ata i kanë dhënë famë emrit të tyre nëpërmjet interpretimeve apo performancave spektakolare në film, art apo muzikë. Por, duket se këta VIP-a pas debateve të momentit janë kthyer në armiq të përbetuar.

### GENTA ISMAILI DHE DAFINA ZEQRIRI

Ata janë të dyja këngëtare shumë të njohura dhe të kërkuara kudo në Shqipëri, Kosovë dhe në diasporë. Sipas "Albeu", duket se asnjëra prej të dyjave nuk gëzohet për suksesin e tjetrës. Kohët e fundit pas një konfliktit që Genta Ismaili pati me menaxherin e saj personal, ky i fundit nuk ka hezituar të bëjë disa deklarata të forta kundër këngëtares, ku ndër të tjera ka theksuar: "Gentën e merron suksesin e Dafina Zeqirrit dhe e shan shumë atë". Dafina dhe Genta kanë qenë rivale të flakta gjatë viteve të fundit, me një ndarje 50 me 50 të fansave.

### ROZANA RADI DHE REZARTA SHKURTA

Padyschim janë dy nga artistet më të komentuar në shtypin rozë, pas konfliktit që degjeneroi me dhunë fizike. Krisja me Rozana Radit dhe Rezarta Shkurtës (që më herët janë njohur si dy mikeshë të mira në rrethin e artistëve), nisi në shoun "Vip Shpija" në Kosovë. Në dukje ishte një zënkë banale dhe vetë ato të dyja u përpoqën ta kalojnë me sportivitet, duke urruar njëra-tjetrën për suksesin e radhës në festivalin "Kënga Magjike". Po historia nuk do të mbaronte këtu. Pak kohë më vonë do të dëgjonim se dy vajzat ishin zënë keq me njëra-tjetrën e madje konflikti kishte shkuar deri të dhuna fizike. Të dyja artistet pretenduan pafajësinë dhe pas një procesi të gjatë, gjykata vendosi që ta shpallte Rezarta Shkurtën jofajtorë ndaj akuzave të Radit, e cila nga ana tjetër ka thënë se do ta çojë çështjen në Gjykatën e Apelit. Nuk e dimë nëse Rozi e ka bërë apo jo këtë veprim të ri ligjor për të marrë pafajësinë e pretenduar, por e sigurt është që këto dy ish-mike dhe këngëtare të njohura nuk do të jenë më kurrë mike si më parë.

### ADELINA ISMAILI DHE LEONORA JAKUPI

Ka qenë ndoshta nga historitë e para të sherreve. Që ka ndodhur gati një dekadë më parë. Rrahja mes dy këngëtareve të njohura të skenës kosovare, Adelina Ismaili dhe Leonora Jakupi ende sot e kësaj dite mbetet e pasqaruar tërësisht për publikun dhe vetëm pak muaj më parë këngëtares e i janë rikthyer asaj me



diatikisht. Në një intervistë që i është bërë njëres nga këngëtares me të famshme në të dyja anët e kufirit, Adelina Ismailit, ajo ka thënë se "ka qenë rrahje, jam shpallur e pafajshme. S'ka qenë ndonjë tragjedi ndërkombëtare". Ndërsa pyetjes nëse janë pajtuar, i është përgjigjur: "Nuk e shoh të arsyeshme. Jo pas asaj që

më ka bërë pas rrahjes. Aq bukur e ka shfrytëzuar për karrierën e vet dhe për krijimin e lidhjeve me mediat e ndryshme. Për mua ka qenë ndryshe, se unë jam rugoviste, jam ende", ka thënë Adelina. Pas deklaratave të Adelina, nuk ka munguar reagimi i këngëtares tjetër të njohur, Leonora Jakupi, e cila është shpre-

hur se kërkon ballafaqim publik. "Asgjë nga ato që ka thënë nuk është e vërtetë. Nuk mund të dalë në një studio ashtu kot dhe të thotë gjëra të paqena. Pse doli të flasë për këtë çështje pas 10 vitesh?! E ftaj në një debat publik, sepse në ndryshim nga ajo, unë i kam gjërat e faktuara", ka thënë Leonora Jakupi për "Prive". Historia

e rrahjes ka ndodhur 10 vjet më parë në "backstage"-t e një koncerti, ku bëheshin parapërgatitjet për regjistrimet e një spektakli për Vitin e Ri. Ende nuk dihen arsyet se përse ato janë zënë atë kohë, veç thashethemeve se rrahja e tyre më shumë ka qenë për çështje politike sesa për çështje xhelozie.





Dikur bashkëpunuan, ja pse nuk flasin sot me njëri-tjetrin Samanta dhe Big Basta. Ata janë në mesin e artistëve që vite më parë kanë bërë një duet. Ekipi i emisionit "Mirage" ka realizuar një klip, përmes së cilit tregon emrat e artistëve që dikur kanë pasur bashkëpunime, ndërsa sot nuk flasin. Në këtë klip mund të kuptoni edhe arsyen përse Samanta dhe Big Basta nuk flasin pas duetit që kishin.

Dikur bashkëpunuan, ja pse nuk flasin sot Samanta dhe Big Basta



Këngëtarja Rovena Stefa prezantoi klipin e ri të titulluar "Jeta Jeta". Këngë kjo, e cila duket se nuk ka tërhequr shumë publikun pasi ka arritur të mbledhë pak shikime në "Youtube", ndonëse u mundua të shfaqej provokuese me veshjen në klip, e veshur me taka në mes të shkretëtirës. Per ata që kanë parë klipin, një detaj që mund t'ju ketë ikur është se Rovena aty shfaqet pa të brendshme, madje ka momente që duket qartë që është pa to, një trend ky që shumë nga yjet po e bëjnë. Pavarësisht se jo shumë e shpesh të projekteve muzikore, Rovena është mjaft e angazhuar me koncerte dhe dasma gjatë sezonit veror. Ndersa, sa i përket jetës private, këngëtarja është treguar gjithmonë e rezervuar, duke mos zbuluar nëse është 'single' apo e lidhur.

Publikoi klipin me veshje provokuese, Rovena shfaqet edhe pa të brendshme



Aktorja Olta Gixhari ka ngjallur sërish tundimet me pozat e saj seksi. Aktorja ka ndarë një foto mjaft provokuese, ku gjendet shtrirë në një divan. Një detaj i lenë enkas nga aktorja ka tërhequr vëmendjen. Vërtet një 'sexy bombë'.

Kush e ka "grisur" Olta Gixharin, publikohen pamjet provokuese



Noizy është një prej reperëve më të komentuar dhe më të pëlqyer nga rinia shqiptare. Popullaritet i tij është rritur ndër vite e po ashtu edhe fansat që e mbështesin. Në një foto të fundit të publikuar në profilin e tij në "Instagram", komentuesit kanë kapur një detaj të pazakontë. Një pjesë e flokëve të tij mungon dhe është përthunur me sfondin, ndërsa mjekra e reperit është shfaqur në ngjyrë lejla.

Noizy e tepron me fotoshopin, fansat tallen keq me këtë detaj në foto

# BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

**POLITIK**

## Ndaloi me urdhër celularët, ministrja s'e lëshon nga dora...

Nxënësit nuk lejohen më me celularë gjatë orës së mesimit. Urdhri i firmosur nga ministrja e Arsimit, Lindita Nikolla, pak para fillimit të vitit shkollor, ndalonte rreptësisht përdorimin e celularëve gjatë procesit mësimor si nga nxënësit, ashtu dhe nga mësuesit. Ky urdhër hynte në fuqi menjëherë dhe njësitë arsimore vendore dhe drejtoritë e shkollave ishin përgjegjës për zbatimin e tij, për marrjen e masave sipas akteve normative në fuqi në rast të shkeljes së tij. Por siç mund ta shikoni në këtë foto, celularët janë mbi tavolinë edhe gjatë një vizite të ministres, e cila gjithashtu s'e lëshon celularin nga dora.



## Trump 'nuk di' si mbyllet çadra, video virale në rrjet

Që presidenti amerikan nuk ka një raport të mirë me çadrat nuk është një sekret. Por këtë herë, video që tregon se si ai braktis çadrën e hapur në hyrje të avionit presidencial bën të lindin dyshime që Trump nuk është në gjendje të mbyllë një çadër. Donald, pasi është ngjitur në avionin e tij Air Force, nuk shqetësohet aspak për ta marrë me vete çadrën, por e lë atë në mes të erës dhe shiut. Duhet ndërhyrja e një pjesëtari të stafit për të evituar që ajo të bjerë poshtë. Të menjëhershme kanë qenë kritikant në rrjetet sociale: 'E pabesueshme, nuk di si funksionojnë çadrat', -thonë përdoruesit në internet.



## Ministri romantik, publikon fotot e gruas për të promovuar '100 fshatrat'

Ministri i Bujqësisë Niko Peleshi tërhoqi vëmendjen me postimin e tij në rrjetet sociale. Si rrallë ndonjëherë Peleshi publikoi fotot e bashkëshortes së tij për të promovuar në njëfarë mënyre programin '100 fshatrat'. Siç duket këtë fundjavë ministri ndodhet në Dardhë të Korçës, me familjen ndërsa në rrjetet sociale është treguar romantik. 'Mos e humbisni vjeshtën në Dardhë', shkruan Peleshi në dritare.



## Djali i Bashkim Finos martohet me vajzën e zyrtarit të LSI

Redi Fino dhe Edlira Podgorica. Djali i deputetit të PS Bashkim Fino, Redi Fino martohet me vajzën e Gëzim Podgoricës, ish-drejtor i Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH) dhe anëtar i Kryesisë së LSI. Redi Fino do i japë fund beqarisë duke kurorëzuar lidhjen me Edlira Podgoricën, raporton newsbomb.al. Dasma pritet të zhvillohet së shpejti dhe për detajet lidhur me të ftuarit apo ceremoninë do të shkruajmë në vazhdim.



**Ngjarja në Gjermani, tronditë se çfarë ka ndodhur**

**Infermieri serial-killer pranon:  
Kam vrarë 100 njerëz me ilaçe**

**# VRASESI NIELS HOGEL**

Akuzohet se ka vrarë 36 pacientë në Oldenburg dhe 64 në Delmenhorst mes viteve 1999-2005. Kur u pyet në gjykatë nëse akuzat ndaj tij ishin të vërteta, Hogel pohoi të kishte vrarë "pak a shumë" të njëjtin numër.

të njëjtët pacientë.

Ai akuzohet se ka vrarë 36 pacientë në Oldenburg dhe 64 në Delmenhorst

mes viteve 1999-2005. Kur u pyet në gjykatë nëse akuzat ndaj tij ishin të vërteta, Hogel pohoi të

kishte vrarë "pak a shumë" të njëjtin numër. Hogel u arrestua në vitin 2005 pasi u kap duke i injektuar doza të parekomanduara një pacienti në Delmenhorst. Në vitin 2008 ai u dënua me 7 vite burg për vrasje në tentativë. Në vitin 2014-2015, një tjetër gjyq e gjeti fajtor për dy vrasje të tjera në tentativë duke e dënua me dënim të përjetshëm. Provat e reja tashmë e përfshijnë ish-infermierin në vrasjen e 100 pacientëve të tij.



Infermieri serial-killer, Niels Hogel

Zbulohet serialkilleri Zmë i madh në Gjermaninë e pasluftës dhe ky është infermieri Niels Hogel. Në ditën e parë të gjyqit kundër tij, ai ka pranuar se ka vrarë 100 pacientë në qytetin gjermano-verior të Oldenburgut. Detektivët thonë se 41-vjeçari Niels Hogel u dha doza fatale ilaçesh pacientëve nën kujdesin e tij, në dy spitale në veri të vendit. Arsyeya pas këtij veprimi, thonë ata, ishte dëshira e tij për të lënë përshtypje tek kolegët duke "ringjallur"

**Kryeministri: Duhet të dimë të bashkohemi. Ka fakte shumë inkurajuese**

**Dialogu me Kosovën, Haradinaj: Do e gjejmë gjuhën**

*Të mërkurën parlamenti kosovar, në seancë të jashtëzakonshme*

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj është shprehur optimist se në seancën e jashtëzakonshme të thirrur nga opozita në Kuvendin e Kosovës ditën e mërkurë, ku pritet të diskutohet dialogu me Serbinë, grupet parlamentare në pushtet dhe opozitë do të gjejnë gjuhë të përbashkët, për sija tha ai. "mbrojtjen e territorit, kufijve dhe kushtetutshmërisë".



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

"Unë besoj se nesër (e mërkurë) do ta gjejmë një gjuhë të përbashkët. Nuk besoj se ka një subjekt politik në parlament që është kundër ruajtjes së territorit, të kufijve, të kushtetutshmërisë së vendit tonë. Besoj dhe shpresoj që do ta gjejmë një gjuhë të përbashkët. Është inkurajues fakti që në këtë seancë të thirrur nga opozita do të marrë pjesë edhe pozita dhe mendoj se ky është një

lajm i mirë", ka thënë Haradinaj në një konferencë për media pas mbledhjes së qeverisë. Të mërkurën pritet të mbahet seanca e jashtëzakonshme e thirrur nga 42 deputetë nënshkrues, ku do të

kërkohej që presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi të mos flasë në dialogun me Serbinë në Bruksel, për territorin e Kosovës. Partitë shpresojnë që pas debatit parlamentar, të mund të miratojnë një rezolu-

lutë, e cila do t'ia ndalonte Thaçit shpалosjen e idesë së tij, siç e quan ai. "të korrigjimit të kufirit" dhe që sipas presidentit nënkupton bashkëngjijtjen e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me ter-

**Vuçiç, serbëve: Mos u bëni pjesë e ushtrisë kosovare**

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçic u ka bërë thirrje serbëve të Kosovës që të mos marrin pjesë në ushtrinë e ardhshme të Kosovës. Ai i ka bërë këto komente pas një takimi në Beograd me udhëheqësit e Listës Serbe, e cila është partia kryesore e serbëve në Kosovë. "Edhe një herë, u bëj thirrje serbëve të Kosovës që të mos marrin pjesë në ushtrinë e saj. Publikisht dhe hapur, u bëj thirrje që të mos marrin pjesë sepse Kosova po e formon atë ushtri për asgjë tjetër përveçse t'i shfrytëzojë ata serbë që një ditë të qëllojnë mbi serbët. U bëj thirrje serbëve të mos u ndihmojnë atyre në këtë punë të pistë", ka deklaruar ai. Ai shtoi se në 18 muajt e ardhshëm do të ndajë mbi 50 milionë euro për objektet infrastrukturore në Kosovë. "Do të fillojmë ndërtimin e Qendrës Klinike në Graçanicë. Do të ndërtojmë qendra turistike, do të investojmë në rrugë, infrastrukturë dhe furnizim me ujë", ka thënë Vuçic.



**MOTI I KEQ, 9 VIKTIMA NE ITALINE VERIORE**

Erërat e fuqishme, reshjet e dendura dhe përmbytjet mbërthyen gjithë Italinë, duke u marrë jetën 9 personave brenda 24 orëve, ndërsa një tjetër rezultoi i zhdukur. Thyerja e pemëve nga erërat e forta u bë shkak për disa aksidente rrugore në Romë e qytete të tjera. Reshjet shembën tavanin në një sallë të Universitetit Politeknik të Milanos. Autoritetet u detyruan të mbyllin sheshin e Shën Markut në Venecia, pasi niveli i ujit arriti në lartësinë e gjuhëve. Shumë shkolla dhe institucione publike qëndrojnë të mbyllura. Ndërkaq në Francë, problemet i shkaktoi dëborë e dendur. Qindra automjete mbetën të bllokuara në rrugë, ndërsa mbi 150 mijë shtëpi janë pa energji elektrike nga dëmtimi i linjave.



FOTOLAJM

ritorin e Kosovës. Kryeministri Haradinaj tha se spektri politik duket se ka reflektuar pas vizitës së ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit për Çështje Evropiane, Matthew Palmer në Kosovë, andaj sipas tij, ky hap duhet të konkretizohet me mbrojtjen e territorit. "Kjo vizita e fundit e zotit Palmer dhe shumë takime që kanë ndodhur, kanë bërë që të ketë një reflektim pozitiv të spektrit politik. Mendoj që është mirë ta kurorëzojmë atë vizitë, atë kujdes të Amerikës për proceset e rëndësishme në vendin tonë me një pozicion të qartë strategjik që të mbrohen kushtetutshmëria, terri-

tori dhe kufiri. S'ka rëndësi se kush më shumë ka kontribuar në atë rezolutë, e rëndësishme është të ruhen interesat nacionale dhe unë besoj që edhe Aleanca edhe Nisma, PDK-ja dhe partitë politike, nuk e kanë problem që të mbrojnë territorin", është shprehur kryeministri i Kosovës, Haradinaj madje e ka krahasuar seancën e së mërkurës me seancën për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri, duke thënë se beson se është e po të njëjtit karakter "edhe mbrojtja e territorit, kufijtë dhe kushtetutës". "Duhet të dimë të bashkohemi", ka thënë ai. (evropaonline.org)

## KONFERENCA SHKENCORE

# “Ne, robërit gjermanë të luftës në Shqipëri. Qelitë e tejmbushura, flinim në çimento”

Fatmira Nikolli

Marenglen Kasmi: Rrëfimet e të dhënat për robërit e punën e detyruar gjatë viteve 1944-1952

Shënimet e kujtimet nga kampet, burgjet e punët që bënë derisa u riatdhësuan

Deri në vitin 1946, trajtimi si robër luftar ishte relativisht i mirë. Lëvizin të pakufizuar dhe po ashtu kishin ushqim të mjaftueshëm. Por, situata ndryshoi menjëherë, pas mbërritjes së misionit të parë ushtarak sovjetik në Shqipëri, në vitin 1946\* (9 gusht 1951, ish-ushtaraku gjerman Friedrich Husselbach).

Historia e robërve gjermanë të Luftës së Dytë Botërore që shtrihet në një hapësirë kohore prej më se 17 vitesh, u trajtua nga Dr. Marenglen Kasmi dje në konferencën Shkencore Ndërkombëtare “TË MOHUAR NGA REGJIMI” organizuar nga Autoriteti për Informim mbi Dosjet e Sigurimit të Shtetit. Kasmi tha se qysh prej fillimit të luftës në shtator 1939, e deri në fillim të vitit 1956, ushtria gjermane “mbolli” robër luftar në 20 shtete të ndryshme e në të gjithë vendet, ata u përdorën në frontet të vështira punë, për të rindërtuar vendet e shkatërruara nga lufta. Në Shqipëri, ashtu si në çdo vend tjetër ku shkeli këmba e ushtarit gjerman dhe u luftua ndaj pushtesit, u kapën robër gjermanë, të cilët u përqendruan në kampe robërish, me saktë kampe pune të detyruar. Madje, ende nuk ka një shifër të saktë të numrit të tyre. Sipas Kasmit, mungojnë të dhënat për trajtimin e tyre, punët që ata kryen në Shqipëri gjatë viteve të burgimit si edhe për procedurat e riatdhësit të tyre. Kjo temë është rrahur pak ose aspak në pikëpamje të një analize shkencore historike. Ai thekson që, si në arkiivat tona ashtu edhe ato gjermane, dokumentacioni është i pakët. Gjithsesi, nga shfrytëzimi i fondëve arkivore të AQSH, MPB dhe të arkivit të Lidhjes Popullore për ushtarët gjermanë të rënë në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, mund të arrijmë në disa konkluzione.

## NUMRI I ROBERVE

Kasmi vuri në dukje se numri i robërve gjermanë të luftës në Shqipëri nuk është i saktë dhe parqitet i ndryshëm, si në burimet shqiptare, ashtu edhe në ato gjermane. Në një informacion të hartuar në vitin 2000 nga Arkivi Qendror i Shtetit, arrihet në përfundimin e përgjithshëm se, pas Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri kanë qenë rreth 1523 robër gjermanë. “Ish-robi gjerman Alfred Wagner, në një letër që ai i dërgon ish-ministrit bavarez Franz Josef Strauß, pasi ky i fundit vizitoi Shqipërinë në vitin 1984 jep të dhëna. Wagner u kthye në shtëpi më 30 qershor 1950, pas gati gjashtë vitesh të vështira robërie në Shqipëri. Ai shkruan se, në Shqipëri kishin qenë pothuajse 1000 robër gjermanë dhe se qysh në vitet e para të robërisë, si pasojë e kushteve të



Historiani Marenglen Kasmi

këqija të jetesës dhe të punës së rëndë kishin vdekur rreth 300 robër gjermanë. Ndërsa një grup i vogël robërish gjermanë, që ishin specialistë, trajtoheshin në mënyrë të diferencuar”. Alfred Wagner ishte një nënofficer i Wehrmacht-it gjerman, që në vitet 1943-1944 u komandua në Shqipëri, si kryellogaritar dhe nënofficer furnizimi në batalionin e 999 të Wehrmacht-it. Në këtë batalion shërbenin ish-të dënuar politikë, kundërshtarë të regjimit nacionalsocialist, ish-të burgosur etj., të cilët fillimisht ishin konsideruar si të padenjë për të shërbyer nën armë, por me rritjen e nevojës së Gjermanisë për ushtarë, u rekrutua edhe kjo kategori në reparte të veçanta.

## RRËFIME ROBËRISH

Kasmi thotë se më 11 nëntor 1944 ai dhe katër shokë të tij u zunë rob nga partizanët gjatë tërheqjes në rrugën Librazhd-Elbasan. Mesa duket, kolona ku bënte pjesë edhe repartit i Wagnerit ishte pjesë e grupimit të Artilerisë që komandohej nga koloneli Styerer, e cila përbëhej nga forca gjermane të dislokuara në Greqi, të cilat në Strugë morën urdhër të marshonin në drejtim të Tiranës, për të ndihmuar gjatë tërheqjes forcat gjermane që ndodheshin në Tiranë. Sipas tij, brenda një kohe shumë të shkurtër, në bazë të marrëveshjeve bilaterale ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë, ushtarët italianë u lejuan të largohen për në vendlindjen e tyre, ndërsa

robërit gjermanë u përdorën për të kryer punë të ndryshme. Sa e rëndësishme ishte puna që bënin robërit gjermanë për vendin e shkatërruar të sapo dalë nga lufta e tregon fakti që, pas fillimit të negociatave për lirim të robërve gjermanë që ndodheshin në Shqipëri, të organizuara në qershor 1950 nga Ambasada e Republikës Demokratike Gjermane në Rumani, instancat shqiptare u munduan të pengonin riatdhësimin e gati gjysmës së robërve gjermane duke ngritur akuza të paargumentuara, me qëllim shfrytëzimin e mëtejshëm të tyre.

Kumtesa e Kasmit tregon se më 9 gusht 1951, ish-ushtaraku gjerman Friedrich Husselbach, i cili në janar të po këtij viti sapo ishte kthyer nga Shqipëria, raportoi në Qendrën për Kërkimin e të Humburve në Luftë, në Kassel të Gjermanisë, ku thekson se numri i robërve gjermanë të luftës në Shqipëri ishte rreth 650 burra. Një pjesë e konsiderueshme e tyre kishin qenë efektivi i batalionit të të dënuarve të luftës së Dytë Botërore të robërit gjermanë do të riatdhësohen së shpejti, gjithë robërit gjermanë u grumbulluan në Tiranë. Sipas Husselbach-it, prej këtyre ditëve filluan vuajtjet e robërve gjermanë. Ata u tërhoqën në punë të detyruar në kuadër të rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta. Uria dhe sëmundjet u bënë pjesë e pandarë e jetës së robërve gjermanë. Si pasojë, në vitet 1949-1951, vetëm 227 robër gjermanë arritën të riatdhësohen. Vetë Husselbach-u u kthye në shtëpi me transportin e fundit të organizuar në vitin 1951, me një anije sovjetike që u nis nga



Robër gjermanë

“39 ditë pa një lugë gjellë të ngrohtë, pa ujë për t’u pastruar, 39 ditë pa parë ditë me sy, 39 ditë ku tre burra ndanin një bukë më pak se 0.5 kg”, - shkruante ish-ushtari Walter Enge

Durrësi, nëpërmjet Dardaneleve dhe mbërriti në Konstancë, Rumani. Prej Konstancës udhëtoi me tren në linjën Bukuresht-Budapest-Pragë-Dresden.

Sipas Husselbach-it, rreth 423 robër gjermanë kishin humbur jetën në Shqipëri si pasojë e sëmundjeve, urisë dhe punës e jetesës së vështirë. Kasmi sjell më tej dëshminë e Paul Kahlenberg, rob gjerman në Tiranë, që më 15 shtator 1948 shkruan një thirrje për ndihmë në Gjermaninë Lindore. Ai njoftonte se, në Tiranë ishin 217 robër gjermanë, dhe njëmbëdhjetë prej tyre antifashistë që kishin shërbyer në batalionin e të dënuarve 999 të Wehrmachtit gjerman. “Mos duhet që ne antifashistët të derdhim edhe për shumë vite gjak për klikën, ndërkohë që gjithë ish-nazistët janë kthyer në shtëpi”, shkruante Husselbach-u në thirrjen e tij.

Një dëshmi të plotë për robërit gjermanë jep më 25.06.1949 edhe Walter Enge nga Auerwalde i Gjermanisë Lindore, pasi ishte kthyer nga kampet shqiptare. Ndër të tjera ai shkruan: “[...] Dëmet e luftës ishin shumë të mëdha, por rindërtimi filloi shumë shpejt. [...] Ne shumë herë ndihmuam për transportin me kamionë të mallrave të konfiskuara si, makina, makineri, ushqime, vaj etj. Këto u vunë në dispozicion të ndërmarrjeve të reja për të rigjallëruar ekonominë e re. [...] Ne, si robër luftar kemi një meritë të madhe për rindërtimin [e Shqipërisë] dhe, kjo është e pamohueshme. Kjo është na u tha edhe kur na liruam. Ne ishim rreth 150 robër gjermanë dhe 800 robër italianë në kampin



Posteri i konferencës







ISH-TRAJNERI I KOMBËTARES



Ish-trajneri i Kombëtares Lkuqezi, Xhani De Biazhi, ka folur së fundi për "Il Milanista", duke pranuar për të disatën herë se ishte shumë pranë stolit të Italisë. Ai ka folur më shumë për situatën te Milani, duke u shprehur se skema 4-4-2 i jep më shumë ekuilibër skuadrës së Gatuos, por ka prekur edhe temën e kombëtares italiane: "Milani nuk ka gjetur ekuilibër pas 10 javësh. Skema 4-4-2 ndaj Sampdorias i shkon për

De Biazhi: Shqipëria, përvoja më e bukur për mua

shtat Higuainin dhe Kutronen, që me skemat e mëparshme sakrifikoheshin. Mendoj se Italia nuk ka shumë talente kohë e fundit dhe ky është një problem thelbësor. Kemi lojtarë të mirë, por që nuk kanë përvojë për ta udhëhequr kombëtaren. Italia e Maldinëve, Nestave, Totëve dhe Del Pierove nuk ekziston në këtë moment. Për

voja në stolin e Shqipërisë ishte ndër më të rëndësishmet për mua, pse jo më e rëndësishmja në jetën time profesionale. Kemi bërë diçka që në fillim askush nuk mund ta imagjinonte, shkuaam në Euro 2016. Besoj se ka lindur gjithçka nga puna e bërë dhe nga vullneti i lojtarëve. Stoli i Italisë? Kur u zgjodh Ventura, kam qenë shumë afër deri

në momentin e fundit për t'u bërë axurr, por gjërat morën rrjedhë tjetër. Ndodhi sepse Federata Shqiptare e Futbollit nuk donte të më lironte, por edhe sepse Ventura ishte zgjedhur. Isha shumë pranë. Tani dua të gjej një mundësi që të më pëlqejë. Kam refuzuar disa oferta që më kanë ardhur, mes tyre edhe kombëtaren e Armenisë", - ka thënë De Biazhi.

Federata kërcënon klubin e kuq: Komisionet do të mblidhen urgjentisht për incidentin



Jeton Selimi

# Parulla raciste në stadium, FSHF do të ndëshkojë Partizanin

## "Ultras Guerrils" distancohen dhe dënojnë mesazhin

Është futboll, është festë! Pak rëndësi ka kush fiton, rëndësi ka atmosfera, futblli i bukur dhe tribunat plot. Thënë këtë, çdo gjë që është jashtë këtij spektri, nuk i përket futbollit. Aq më tepër ajo parullë e turpshme e hapur dje në stadiumin "Selman Stërmasi", që ishte plot gjuhë urrejtjeje dhe raciste kundrejt fqinjëve grekë dhe që kërkonte të evokonte vrasjen e ndodhur në fshatin Bularat, ku mbeti i vranë nga forcat Renea pasi kishte hapur zjarr ndaj tyre, terroristi Kostantinos Kaçifas. Mesazhi i hapur në fillimin e ndeshjes u hoq me shpejtësi po nga tifozë të tjerë të Partizanit, të cilët nuk ishin dakord me të, por jehona e bërë ishte e madhe dhe natyrisht që lë shije të hidhur. Të parët që kanë reaguar kundër këtij mesazhi ka qenë tifogrupi i Partizanit, "Ultras Guerrils", të cilët kanë dashur të sqarojnë se nuk janë përgjegjës për të. "Sqarojmë se tifozëria e organizuar e Partizanit dhe grupimi Ultras Guerrils nuk ka lidhje me parulla raciste të shfaqura nga individë në stadium. Nuk i mbështesim parulla të tilla që na bara-



zojnë me nivelin e një ekstremisti. I bëjmë thirrje mediave të promovojnë ko-reografitë dhe elementët pozitivë e mos të instrumentalizojnë parulla të tilla që

nuk përfaqësojnë qëndrimin e tifozërisë së kuqe". Pak më pas ka qenë klubi i Partizanit që ka thënë fjalën e tij. "Falë masave të marra organizative, takimi Partizani-

Skënderbeu rezultoi një festë e vërtetë sportive e denjë për një ndeshje vitrinë të kampionatit tonë. Njëkohësisht dëshirojmë të distancohemi nga episodet sporadike

(rasti i banderolës), të cilat nuk kanë lidhje me eventin sportiv, dhe bien ndesh me politikën Fair-Play të Klubit. Sporti duhet t'i bashkojë njerëzit dhe jo të krijojë përçarje mes tyre. Një falënderim i veçantë shkon për tifozërinë e kuqe, e cila me pjesëmarrjen e saj masive, në këtë ndeshje, këngët dhe përklarjen e fuqishme përjetatë gjithë takimit, dhuruan një atmosferë të mrekullueshme", shkruhet në njoftimin e klubit, që ka thumbuar njëkohësisht dhe klubin e Skënderbeut, pasi ndeshja e parë e zhvilluar në Korçë kaloi në kaos për shkak të mungesës së organizimit nga ana e klubit pritës. Por në mbërmjen e djeshme ka reaguar edhe Federata Shqiptare e Futbollit, që i është bashkuar korrit kundër

mesazhit racist dhe ka kërcënuar Partizanin me një dënim të mundshëm. "Duke i nxjerrë kartonin e kuq këtij rasti të rrezikshëm për imazhin e futbollit, i sigurojmë të gjithë se do të merren të gjitha masat përkatëse që raste të tilla shënarësh dritëshkurtra jo vetëm të mos kalojnë pa u ndëshkuar, por kurrsesi të mos përsëriten e mos njozolosin imazhin e lojës së futbollit. Duke theksuar se mbetet në përgjegjësinë e klubit parandalimi i këtyre incidenteve, në rastin aktual i klubit Partizani, bëjmë me dije se komisionet juridike pranë FSHF-së do të mblidhen në mënyrë urgjente dhe do të shqyrtojnë të gjithë incidentin për të vijuar me masat përkatëse".

TRAJNERI SQARON SITUATËN

Mërgjyshi: Largohem nga Laçi për motive personale

Artan Mërgjyshi nuk është më trajner i Laçit. Trajneri kryeqytetas nuk ka dalë në stërvitje me ekipin dhe pas intervesimit të "Vipsport.al", ai ka konfirmuar se ka mbyllur gjithçka me ekipin kurbinas. "Po, e mbylla me Laçin. Për arsye personale". Kaq ka thënë trajneri Mërgjyshi, duke mos dashur të zgjatet në arsyet që sollën largimin e tij nga Laçi. Skuadra bardhezi ka pësuar dy humbje në javët e fundit nga Kukë-



si dhe Teuta, por nuk është ende e qartë, nëse drejtues-

it e Laçit kanë marrë vendimin për ndërrimin e trajnerit nga rezultatet e fundit. Tashmë duhet pritur të mësohet emri i trajnerit të ri të Laçit, që do të ishte i treti në këtë sezon. Gjatë ndeshjeve europiane ekipin kurbinas e drejtoi Besnik Prena dhe më pas vendin e tij e mori Artan Mërgjyshi. Me të në krye, Laçi pati një ecuri të mirë, duke përfunduar dy humbjet e fundit. Aktualisht, kurbinasit mbajnë vendin e katërt me 16 pikë.

DREJTORI I SKËNDERBEUT


Fakiç: Jemi optimistë për gjyqin ndaj KAS-it

Në vitet e fundit, Skënderbeu ka shkruar histori në futbollin shqiptar, duke u kualifikuar edhe dy herë për në grupet e Ligës së Europës dhe natyrisht merita për këtë ecuri, ka edhe drejtori sportiv Haris Fakiç, i cili ka dhënë ndihmën e tij në përzgjedhjen e lojtarëve. Në një prononcim për "Supersport", Fakiç është shprehur se Skënderbeu i ka pasur shumë nga këta futbollistë në gjurin e tij, por që i akne munguar minutat. Sakaq, ai pranon se ky Skënderbeu, është më i bukur i sezoneve të fundit, ndërkohë që ka folur edhe për KAS-in.

"Skënderbeun duhet të jetë prapë Skënderbeu dhe besoj se kemi arritur të jemi afër objektivit, gjithsesi mendoj se ecuria deri më tani është mjaft e mirë. Na kënaq loja dhe ekipi. Të them të drejtën për mendimin tim është ekipi më i bukur i Skënderbeut në vitet e fundit. Futbollistët i përzgjedhim më herët dhe ky është rezultat i punës që është bërë. Ka futbollistë që kanë dy vite në ekipin tonë dhe nuk e kanë pasur mundësinë të luajnë nga konkurrenca. Tani u ka ardhur koha atyre të kenë minuta dhe kanë momentin të

trëgojnë kualitetet që kanë. Neve na vjen ky moment shumë i mirë pasi nuk kemi pasur nevojë të kërkojmë lojtarë të tjerë, pasi ishim të kompletuar. Pagat? Klubi Skënderbeu është ekip i stabilizuar. Pavarësisht problemeve, nuk do të ketë dhe nuk ka pasur kurrë probleme pagesash. Ajo është fryrë më shumë nga mediat sesa sa ka qenë reale. KAS? Shpresojmë dhe do të vazhdojmë të shpresojmë pasi e dimë që jemi të pastër dhe besojmë te fitorja në fund", u shpreh Fakiç.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 1. Ishte dekret i sulltanit.
8. Fillojnë nazet.
9. Është bosht.
10. Është studio e Barack Obama-s.
13. Fillojnë romanin.
14. Pak nepozitëm.
17. Mbahen për të ndaluar.
18. Janë njerëz me dy faqe.
21. U mbiquajt Princi i oratorëve.
22. Nofka e Eisenhoëer.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
27. Kush është... nuk është i lirë.
29. Bën be pa u betuar një e tillë.
30. Kështu mbyllet dera.
33. Është për medaljen e parë
34. Janë nofka.

- 38. Satelit i Jupiterit.
39. Fillojnë matjet.
41. Në krye tëv idealisatëve.
42. Një Ibrahim violinist.
44. Ekstre me sirtar.
45. Kështu shtë lojtari i under 21.
47. Është gjuajlja personale.
49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
50. Gëlonin nga gladiatorët.

VERTIKAL

- 1. Eli këngëtare.
2. Pak ekologjike.
3. Rastis në kufij.
4. Janë temperuratur më të ulëta.
5. Inicialet e Lendi.
6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
7. Campion regjisore.
8. Gabim rrjete në tenis.
11. Janë si cilësi.
12. Ishte gjuha e romakëve.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. I vihat kalit.
18. Rrapo i luftëtarëve.
19. Aktet pa kufij.
20. Mbyllet me dorezë.
21. Është periudha e ftohtë.
23. Në krye të komandës.
24. Një artist si Tristan Tzara.
28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
31. Hapin pa kufij.
32. Qethen me qen.
35. Një mendim.
36. Kusturica, regjisor.
37. Parajsja e humbur.
39. Një stacion i famshëm orbital.
40. Pak aromatike.
43. Pak interesante.
46. Lirë në qendër.
48. Nota e diapazonit.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Bunuel regjisor.
4. Të parat në sport.
6. Rodrigues që këndonte fado.
11. I famshmi Pacino.
12. Kujdeset në... ekstreme.
14. Është skllavëri.
16. Është shtypji po përditshëm.
18. Janë tek në banka.
20. Është ndeshje e... fundit.
21. Lumi i Bernës.
23. Janë me numër ato ushtarake.
24. Nesti pa pa çifte.
25. Si gjithë.
26. Sipërfaqe e shkurtër.
27. Ato të peshkut janë pa vlerë
28. Janë marfete... me grim.
31. Ethet e tij zunë kërkuësit.
32. Skuadra merengue.

VERTIKAL


- 9. Është edhe ai i rekordeve.
10. Fleming që krijoi James Bond.
13. Janë binarë.
15. Janë dhoma.
16. Është i zi... pikant.
17. Institucione Lokale Tiranë.
19. Pagëzoi Shën Palin.
20. Është besimi i besimtarëve.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për... gol.
27. Një fjalë për më vonë.
29. Maria Rilke, shkrimtar.
30. Fillojnë turnin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Është copë... torte.
35. Mbyllin një tender.
34. Ndo në kufij.
38. Një përthurë.
40. Lidh dy brigjet.
41. Një pije piratësh.
43. Fillojnë lehtë.
45. Të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

9 1 4 2 5 3 6
6 9 8 4
3 7 5 2
4 2 6 8
8 4 7 1
1 5 8 6 4
2 1 6
7 3 1

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8 4 2 1 7 3 6 9 5
6 5 1 4 9 2 7 8 3
7 9 3 5 8 6 1 4 2
9 1 7 2 3 4 8 5 6
2 8 5 6 1 7 9 3 4
3 6 4 8 5 9 2 1 7
5 2 8 7 4 1 3 6 9
4 3 6 9 2 8 5 7 1
1 7 9 3 6 5 4 2 8


Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Fuqinë e mendjes e ke ti. jo ngjarjet jashtë. Kupto këtë, dhe do të gjesht forcé (Mark Aureli)
Parë nga larg, çdo gjë është e bukur (Taciti)
Pasuria është si uji i detit, sa më shumë njeriu pi aq më i etur bëhet; dhe e njëjta është e vërtetë për famën (Arthur Schopenhauer)
Ne humbëm, sepse i thamë vetes se humbëm (Leo Tolstoy)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME Përgjigja e numrit të djeshëm



Vertical crossword puzzle with words like ARKANA, DIANA, ATLANTIK, etc.



Thënie të mëncura

- Injoranca e vërtetë nuk është mungesa e njohurive, por refuzimi për t'i përfutur ato (Karl Popper)
Nëse përpara lu del një mur, mos u ktheni mbrapa, por mendoni se si t'i vini rrotull, ta kapërcëni ose të kaloni nëpër të (Michael Jordan)
Mos u zemëro me shiun; ai thjesht nuk di se si të bjerë lart (Vladimir Nabokov)
Jo gjithmonë mund të merrni atë që doni, por nëse herë pas here kërkoni, mund merrni çfarë ju duhet (Mick Jagger)

